

BIBLIOTEKA

E

814-32
1959

SHTETI

GJIROKASTER

VËSHTIRËSITË MPOSHTEN

854-32
V 59

VËSHTIRËSITË M POSHTEN

(Përbledhje tregimesh dhe përshkrimesh)

~~48455~~
3341
BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTRA

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

DY FJALE LEXUESIT...

Çdo ditë, çdo orë, çdo minutë e jetës dhe veprimitarisë së popullit tonë është e mbushur me akte heroizmi, vetëmohimi, sakrifice për një qëllim të madh, të përbashkët, për të mos u ndalur kurri, në asnjë moment, marshimi ynë triumfal, me partinë dhe Enverin në ballë, drejt socializmit dhe komunizmit.

Në emër të këtij ideali të lartë, të frysmezuar e të udhëhequr nga mësimet e partisë, punonjësit e vendit tonë punojnë, jetojnë e kaliten si revolucionarë. Njerëzit tanë nuk strukanë në quaskën e interesit të ngushtë personal, por venë mbi qjithçka interesin e përgjithshëm, ata nuk udhëhiqen nga egoizmi i ngushtë personal, por nra çëllimet e përaqjithshme, nra dashuria për Atdheun, për popullin, për Partinë, nga interesat e shoqërisë sonë socialistë në tërësi. Interesi i përgjithshëm vijhet mbi atë personal jo me urdhër, jo me vorosinë e ndokuit, por në mënyrë krejt të vetëvetishme, të ndëraqjegjëshme, si një karakteristikë e vetë ietës sonë sociinliste.

Ngjarjet që përshkruhen në këtë broshurë e që janë nxjerrë nga shtypi ynë dëshmojnë fare

qartë për këtë. Ato rrjedhin në mënyrë krejt të natyrëshme, si detyrë e zakonëshme, e përditëshme. «Kam bërë vetëm detyrën time», «atë që bëra unë do ta bënte kushdo që të ish në vendin t'imi» — kështu shprehen me modesti e thjeshtësi njerëzit tanë. Ata nuk mendojnë e nuk punojnë për lavdi personale, po për lavdinë dhe begatinë e Atdheut tonë, të cilën ata e shikojnë si kusht dhe burim edhe të mirëqënieς dhe lumburisë personale. Një për të gjithë, të gjithë për një — ku motiv karakterizon shoqërinë tonë socialist. Këto mendime e koncepte të larta të moralit socialist, me të cilat partia ka edukuar punonjësit tanë janë burimi i akteve heroike të Adem Rekës, Muhamet Shehut, Myrteza Kepit, Shkurte Pal Vatës, të vullnetit të papërkulur të Fuat Çelës, të qindra e mira she-mbuive të vëniec së interesit të përgjithshëm mbi atë personal. Lufta e ideve të reja të moralit tonë socialist mbi konceptet e ngushta mikroborgjeze të interesit personal, rehatisë, egoizmit dhe lavdisë personale zhvillohet tek ne kudo e vazhdimisht. Njerëzit e rinj të ditëve tona që lindin nga kjo luf-të, ndodhen midis nesh, kudo që punohet e jetohet. Për zbatimin e vijës së partisë e të porosive të shokut Enver që shprehin vetë aspiratat e tyre, për interesat e popullit e të Atdheut, kur e kërkon nevoja ata nuk marrin parasysh as një rrezik. E kjo ndodh në mënyrë kaq të thjeshtë e të zakonëshme! Kjo thjeshtësi është vetë madhështia e jetës sonë.

GJOLI I TURBULLIT U THA

Vepra e tyre të ngjan si një legjendë, si një përrallë e çuditëshme, e pabesueshme. Kufijt e saj shkrihen me përrallat, me bëmat e viganëve të jashtëzakonshëm që çajnë malet. Dhe megjithatë, e gjitha kjo nuk është përrallë, po vepër e ditëve tona. Mehdiu, Ramazani, Petriti, Reshitit, Kamberi, Qemali, dhe Tafani nuk janë diva përrallash, po të rinj nga fshati Gradishtë, i kooperativës bujqësore të Belshit të Elbasanit. Ç'bënë ata?

1.

Ku shkojnë sot në mëngjes ata shtatë vetë? Kanë marrë vare, qysqi, kazma, lopata dhe ngjiten nëpër një rrugë që dredhon kodrave nën një shi të imët, që rizon nga qielli. Sapo ka hyrë muaji dhjetor i vitit 1966 dhe Dumreja me horizontet e gjëra, i ka shkundur gjethet nëpër drurë. Plakat dhe pleqtë kanë nxjerrë kokat nëpër dritare dhe shikojnë me sy të hapur nga habia. «Janë apo s'janë në vete këta?». Po ata të shtatë, të heshtur, ecin nëpër shi njëri pas tjetrit dhe ngjiten nëpër

kodrat ku shushurijnë shkurret. Prapa lenë frikën e pleqve, mosbesimin e disave, përqeshjet e ndokujt. Dhe janë të shqetësuar. Të gjitha i llogarisin me mëndjen e tyre, po nuk kthehen.

Atje përballë, ku mbarojnë kodrat, ngrihet i zymtë dhe i trishtuar Shkëmbi i Turbullit. Nën këmbët e tij hapet gjoli i gjërë, me ujra të thella, plot barishte e qetësi misterioze. S'ka ambient më të zymtë se ky gjol me atë shkëmb të frikshëm, gjithë shpella e plasaritje që reflektohet në ujrat e tij.

... Legjenda thotë se një herë bariut i iku lopa nga tufa dhe rendi drejt gjolit. Ajo shkoi e u fut në një shpellë të shkëmbit dhe nuk doli më. Bariu i gjorë hyri dhe ai në shpellë për ta kërkuar lopën, po dhe ai nuk doli më. Shkoi një fshatar të kërkonte bariun, hyri nëpër guvat e errëta, po mbeti atje përgjithmonë. Atëhere fshatarët e quajtën këtë shkëmb vëndin e xhindëve dhe nuk guxoi më njeri që t'i afrohet. Dhe thoshin më pastaj se nga ai vend dëgjoheshin zëra natën, ahengje e dajre që gumëzhanin gjer në mëngjez. Ka pasur në këto anë dhe një hoxhë që binte këtu të sëmu-rët. Hoxha vinte në guvat e shkëmbit me të sëmu-rin, «thërriste nëpër shpella xhindët», kuvëndonte me ta në gjuhë të çuditëshme netëve të errëta, ndërsa njerëzit rrinin larg e mbanin frymën të trembur.

Po ata të shtatë sot shkojnë drejt këtij shkëmbi me vare, qysqi, dhe lopata. Ky gjol mbulon 250 dynymë tokë të mirë dhe ata kanë vendosur ta thajnjë. Nuk u besojnë përrallave e çudirave që fliten për gjolin e për Shkëmbin e Turbullit. Ky shkëmb është si gjithë shkëmbinjtë dhe ata

duan të hapin në të një tunel që ujrat e gjolit të rrjedhin matanë. Mbrëmë diskutuan për këtë në mbledhjen e rinasë. Ata, si aksion konkret zgjodhën pikërisht këtë, mbasi lexuan pjesë nga raporti i shokut Enver mbajtur në Kongresin e 5-të.

Dhe nuk kthehen prapa, me gjithë frikën që ndjejnë pleqtë e mosbesimin e disave. E dinë që kjo që do të bëjnë është një punë jashtëzakonisht e vështirë. Tuneli në këtë vend s'është si tunelet që kemi parë. Ai në vetvehte është i çuditshëm. Një vrimë me diametër 1 metër që nis nga buza e ujrave, e që futet gati 200 metra në shkëmb dhe atje humbet në humnerën nëntokësore. Si kanë mundur ta bëjnë këtë, krahët e atyre të shtatëve?!

2.

Zbritën në përrua, kaptuan bregun e gjolit dhe iu avitën shkëmbit. Lanë veglat në tokë e nisën të mendohen se nga do t'ia fillojnë. Ky shkëmb është vërtet i çuditshëm. Ngrihet pirgje pirgje, me shpella e guva, me të cara që nisin nga maja e bien gjer poshtë, me vrima e porta që kryqëzohen si një labirinth. Në pamjen e parë të duket gur i fortë strallë, po kur e kap të thërmohet ndër duar; diçka si shtufi apo si masa stalaktitësh të dala në shesh nga ndonjë tërmet i fuqishëm.

U ngul qysqija e parë. Një copë shkëmbi ra përdhe. U ngul kazma e parë, u hoq lopata e parë e dheut... kështu nisi puna. Një punë e shqetësuar, plot ankthe dhe emocione të thella. Krahët e tyre do të thanin një gjol. A do ta bënin dot këtë?

Hapën një gropë dy metra të thellë. Tashti nga fundi i gropës do të niste vrima drejt zemrës së shkëmbit: Një vrimë ku mund të punonte vetëm një njeri duke ecur këmba doras. Zbriti në gropë Kamberi. Punoi një gjysmë ore dhe doli që andej i verdhë dyllë.

— C'ke? — e pyetën shokët të shqetësuar.

— Nuk e di, po m'u muar fryma dhe më vjen për të vjellë.

Ai u çapit çalë-çalë gjer tek një gur dhe u shtrri në kurriz.

Gjashtë të tjerët rrinin të shtangur para tij me fytyra të menduara.

— S'do të kem gjë — tha ai — tashti ndjehem më mirë.

U ngrit, po mentë i merreshin dhe në ballë i bulonin djersë.

Atëhere në gropë zbriti tjetri dhe u fut në vrimën që hapi Kamberi. Ky ishte Qemali. Por, si kaluan nja njëzet minuta duke gjerrmuar gjunjazi, doli dhe ai nga gropë me fytyrë të zverdhur e me ballë të mbytur nga djersët.

— Po ti Qemal? — e pyetën.

— S'e di ç'djall është kjo punë. Dhe mua mu zu fryma.

Shkoi dhe ai e u mbështet mbas një guri duke u munduar të marrë frymë me gjithë mushkëritë.

Atëhere ranë gjatë në mendime të gjithë. Ata nuk e dinin atë ditë se kjo asfiksi u vinte nga gazi karbonik. Në vendin që punonin ata, nën nivelin e gjolit të Turbullit, kishte shumë gaz karbonik. Po si rrinin një orë e ca në ajër të pastër prapë e mirrin vehten.

Si t'ia bënin? A ta linin këtë punë me që u doli një e pa-pritur kaq e madhe? Mbrëmë në mbledhje të rinisë kishin dhënë fjalën, kishin dalë mbi paragjykimet e mosbesimin e disave dhe tashti s'duhej të tërhiqeshin. Ndryshe do të thoni në se Shkëmbi i Turbullit vërtet është i paprekshëm.

U fut në gropë Petriti i vetëdijshëm se dhe atij do t'i zihej fryma. Punoi atje brenda një gjysëm ore e doli i zverdhur e marramenthi. Shkoi në majën e një guri dhe shokët s'e pyetën më. Tashti e dinin se ç'ndodhët atje në fund të tokës. Hyri tjetri, tjetri gjersa i erdhi prapë radha Kamberit. Pastaj prapë u fut Qemali, prapë u fut Petriti Vrima nëntokësore e gjërë sa të futej njeriu këmbadoras, avancoi dy metra. Tani duhej futur në të tubi i betonit, nëntë kuintal i rëndë. Kjo punë do të bëhej kur të sillnin aty tubot e betonit.

3.

Ishte e pesta ditë që punonin dhe vrima kish shkuar gjashtë metra. Ajo tani kish dalë në një të plasaritur shkëmbi dhe përmes kësaj plasaritje dukej një rrÿp i hollë qielli. Po këtu puna ishte me mjaft rrezik. Nga lart shkëmbi mund të shëmbej e nëpër të plasarituren rrezikonte atë që punonte atje thellë. Atëhere ata e hapën nga lart të plasarituren për të futur atje tubin e betonit. Ky tub do të viente vetëm sa për të mbrojtur nga gurët atë që punonte poshtë. E lëshuan pastaj me dërrasa tubin gjer poshtë në vrimë. Dhe një koïncidencë e çuditëshme. Sa ra tubi në fund e po bëhej gati

njëri të futej për të punuar, një masë e madhe shkëmbi u shëmb dhe e ndau tubin më dysh.

Po ata i qëruan gurët, nxorën copat e tubit dhe futën një tjetër. Pastaj Mehdiu u fut e nisi të gryej shkëmbin. S'kish gjë më të lodhëshme se sa të punoje i krrusur. Nxjerr gurë nga përpara, në ballin e tunelit të ngushtë dhe i hedh prapa. Vrima prapa teje sa vjen e mbyllt fare nga materiali i gërrmuar. Ai që e tërheq këtë material të gërrmuar dhe e nxjerr në dalje s'arrin dot ta pastrojë shpejt. Dhe mbi të gjitha ajo asfiksi e tmerrshme. Puno një gjysëm ore dhe rri shtrirë një orë e ca për të marrë vehten.

4.

U bë një muaj që ata punonin në Shkëmbin e Turbullit. Vinin këtu në mëngjez herët dhe iknin vонë, kur pothuaj errej fare. Dhjetori me shira dhe erëra kaloi e tashti kish ardhur janari me cikma e thëllime që të prisnin si brisk. Të shtatë, si shtatë diva përrallash, hynin e dilnin në atë vrimë të gushtë nëntokësore. Hynin atje thellë gjirit të shkëmbit e dilnin me fytyra të zverdhura si nga ethet, të mardhur nga të ftohtit e me këmbë të mpira duke qëndruar gjunjazi. Ç'gjë madhështore që është kjo! Ç'vulnet, ç'heroizëm e ç'shpirt i pëmposhtur që është ky! Vetëm idealet e partisë mund të brumosin njerëz të tillë!

Tuneli nëntokësor tashti kish hyrë njëqind e ca metra thellë. Që të vije gjer në ballin e punës të duhej një kohë e gjatë. Të nxirrje materialin e gërrmuar që andej ishte diçka tepër e vështirë.

Të rintjtë për këtë punë përdornin një karrocë dore. E çonin këtë karrocë gjer në krye duke ecur gjunjazi në pjesën më të madhe të tunelit dhe e nxirrin këtë karrocë po gjunjazi, duke e shtyrë të shumtën e herës me gjoks. Dhe atje thellë ishte errët, një errësirë e thellë e padepërtueshme. Dhe që të punonin në këtë errësirë ata merrnin me vëhte një fener. Një fener tek ai që gërmonte në ballë të tunelit dhe një fener tek ai që shtynte karrocën. Një fener qëndronte atje thellë shkëmbit, poshtë në themelin e tij e një fener që shkonte e vinte, si një xixëllonjë e gëzuar, e gjallë që lëviz, që shtyhet hap pas hapi me gjoks.

Dhe ja se ç'ndodhi një ditë. Shkëmbi u shëmb. Diku në thellësitë e tija ranë masa gurësh dhe mbyllën vrimën e tunelit. Brënda mbeti Kamberi dhe Ramazani. Prisnin shokët që të dilte karroca, po më kot. Kaluan disa minuta. Ç'i ka ndodhur Ramazanit që s'po del? Në ç'vënd ka mbetur karroca e tij që s'po i dëgjohet gërvëlima? Pritën dhe pak e zemra ua ndjeu se diç do të kish ngjarë. Rrëmbyen veglat e rendën njëri pas tjetrit, rendën si ushtarë në një llogore të gjatë nëntokësore. Fener nuk kishin dhe sakaq i mblođhi errësira e thellë. Befas u penguan diku. Shkëmbi ish rrëzuar. Nisën të gërmojnë. Gërmonin si ndër ethe, fryma u mbahej, djersët u rridhnin çurkë, diçka e tmerrshme i rëndonte në gjoks. Po ata gërmonin. Hapën një vrimë dhe errësirën e çpuan dy fenerë të venitur. Kamberi e Ramazani në gjunjë pranë e pranë, kishin hapur një pjesë të tunelit të mbyllur dhe kishin humbur ndjenjat të mbështetur në supet e shoku-shokut. I muarën dhe u zvarrisën me ta drejt dritës, drejt ajrit. Kaluan dy orë, e ca, u ho-

dhën ujë në fytyrë, i tundën e i shkundën gjersa Kamberi dhe Ramazani erdhën në vehte. A ta linin me kaq këtë punë? Tuneli s'kish mbaruar dhe ata kurrsesi s'do të têrhiqeshin.

5.

Po, tuneli ende s'kish mbaruar. Kjo shëmbje i gjeti ata më të fortë, më të paepur se sa mund të kujtonin. Ata u bënë mburrja e gjithë fshatit. Pleqtë përplasnin buzët dhe tundnin kokën të habitur. Të rinj të tjerë ia filluan punës për të hapur kanalin që do të binte ujin nga gjoli tek gryka e tunelit.

Ndodhi dhe një shëmbje tjetër, prapë mbetën dy vetë brënda dhe prapë shokët i shpëtuani.

Po dilte janari. Tuneli tashti ish futur gati 200 metra thellë. Ku do të dilte ai? Të rintjtë çanin përrpara. Ana tjetër e malit ishte akoma larg. Dhe ja, u rrëzua një gur nga balli i tunelit e përrpara atij që punonte u hap një humnerë nëntokësore. Nga kjo humnerë vinte një rrymë e akullt ajri e diku thellë errësirës së panjohur dëgjoheshin gumëzhite ujlash. Nga gumëzhinin këto ujra? Nga vinte gjithë ajo rrymë e ftohtë ajri?

U spraps i riu që punonte, doli në krye e tregoi për këtë. Erdhën pastaj rresht të gjithë dhe u munden me fener të shohin caqet e kësaj humnere. Asgjë nuk dukej vec errësirës dhé ajo gumëzhitje nëntokësore ujlash.

— Mbaroi! — tha dikush, — ujrat e gjolit do të derdhen në këtë humnerë.

Dhe dolën prapë.

... Kanali që ndërtuan të rintjtë, dy metër të

thellë, i qe afruar grykës së tunelit. Ujrat e gjolit u avitën, pastaj hapën pjesën e fundit dhe këto ujra që flinin ndër shekuj në mezin e asaj kurore kodrash, vërvshuan në vrimën nëntokësore. Iknin ujrat, iknin, iknin. Në shesh dilte toka e shëndoshë e gjolit të Turbullit. Këtë tokë 250 dynamëshe vitin që shkoi e mbollën me misër dhe morën rendimente të larta.

* * *

Kështu doli në dritë toka e gjolit të Turbullit. Kjo ngjarje tregon për shpirtin heroik, për sakrifiçen e tyre të pashëmbullt. Do të kalojnë vite e vite dhe vepra e tyre nuk do të harrohet kurrë. Dhe ai Shkëmbi i Turbullit s'do të jetë më vënd legjendash e qëniesh misterioze, vënd kobesh e tregimesh të frikëshme, që rëndonin në ndërgjegjen e fshatarëve, por vëndi, ku shtatë të rintjtë kryen një heroinë të madh. Nën këmbët e tij tashti shtrihet një fushë e bukur pjellore.

«EDHE SHOK I MIRE E I SHKOLLUAR, EDHE BUJK I MIRE KRYETARI YNE»

«Të gjykosh nga pamja e jashtëme për njëritështë njëlloj si të marrësh me mënd thellësinë e detit». Më kujtohen këto radhë kur eci përmes ugareve me këtë njeri që fshatarët e kanë quajtur «njeriu i arave». Fryn erë. Dy brigjet e lumiit duken të shkreta. Uji rrjedh i turbullt, kurse toka është mbuluar me të gjitha ngjyrat e pragut të pranverës. Grunjrat blerojnë, ugaret kanë ngjyrën kafe, të errët, pemët po çelin lulet e para. Gjithëçka e mbarë.

— Toka është bujare, — thotë shoqëruesi im.
— Sa t'i japësh, të jep!

E shikoj këtë njeri që i do kaq shumë tokën dhe bimën. Ecën herë para meje herë pas. Ulet diku dhe vëren me kujdes bimën e grurit. Përsëri tregon një cilësi të saj, që ka të bëjë me rendimentin e ardhshëm.

— Nitrifikimi duhet bërë në kohë, — thotë pastaj, — ndryshe ...

Në udhët e ngushta të arave gjurmët e thella të qerreve kanë lënë vragën e tyre të gjatë. Gjurmë buajsh. Edhe gjurmët tonë mbetën për pak

kohë mbi baltovinë. Një traktor që vjen pas nesh, i mbulon me putrën e tij gjigande metalike.

— Kështu, pra... Punën tuaj s'e njojin të gjithë, — i them.

Ai qesh:

— Timen?

— Jo, në përgjithësi, të arave.

— Arat janë të gjëra, të pasura, kurse njerëzit e tyre të shumtë... Edhe lodhen shumë.

Ai ka vetëm pak muaj që drejton kooperativën bujqësore «Stalin» të Poshnjës, në rrëthin e Beratit. Më parë ka qenë në Teman,

— Si ndryshoka njeriu! — thotë ai. — Kur isha i vogël më pëlqenin hekurat... Shikoja detin e gjérë në këmbët e fshatit, vaporët që lundronin tutje në thellësi dhe mendoja: «Në det duhet të jetë mirë». Kurse tani... e pë ç'kishte në dhomën time? Kampionë toke, lloje bimësh, në zhvillim e sipër, kallinj të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme, fotografi të njerëzve të arave dhe prodhime të ndryshme.

E quajnë Polo. Njeri i zakonshëm. I thjeshtë, e dashuron zanatin e tij. Ishte kryeagronom në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrëthit. Jo se zyra e mërziti, por Temani kishte nevojë. Kooperativë e re...

... Ishte dimër atëhere. Pemëve u kishin rënë gjethet. Përroi i fshatit kish dalë nga shtrati. Rrugëve të Temanit rrëshqisnin këmbët nga balta. Copat e vogla të tokës duke sheshin si të përhime. Dikush i quai hallin: «I shkreti Polo!». Në shtëpi e shoqja i tha:

— Dëgjova se do nisesh.

— Po. Ju përgjigja thirrjes.

— Për sa kohë?
— Ndoshta për tërë jetën. Do të nisem.
— Sot?
— Deri në një farë vendi do të udhëtoj me maqinë, pastaj në këmbë.

— Ma thanë edhe këtë. — tha ajo dhe dolli nga guzhina.

— Vishu mirë. Atje duhet të jetë ftohtë. Janë rroba të leshta. Pastaj je larg. Dëborë. Për vajzën mos ki merak, as për nënën. Na lajmëro kur mund të vijmë...

Ky qe diallogu i atij mëngjezi në shtëpinë e tij.

Arriti në këtë fshat malor kur po perëndonte dielli. Njohu njerëz që flisin një dialekt tjetër. Vocérakë që e thërrisin «xhaxhi». Lodhja e rrugës më shumë iu çfaq kur u shtri në shtratin e drunj-të. Në mesnatë i dhimbnin gjunjtë.

— Mos më pyet përse, por vetja në mëngjezin e parë në Teman m'u duk e çuditëshme. Male për rrëth dhe punë. Kooperativistët më zgjodhën kryetar. E kuption vetë, pra, c'përgjegjësi ra mbi mua nga ky besim i tyre.

U hapën brënda vitit 30 ha. tokë e re. U bë qilizmë. Nën shëmbullin e kryetarit të ri, kooperativistët u hodhën pa rezerva në frontin e punës.

— Ai njeri është i çuditshëm. — m'u kujtuan fjalët që më kish thënë një ditë një kooperativist nga Temani. — Në fillim menduam: E ç'do të bëjë ai? Është agronom i lartë! Po qoftë me shëndet! Pastaj kur e njohëm në punë, ndryshuam mendim. Fliste për njerëzit, mendonte për tokën. Ishte java e parë. Në katojtë tani kishte shumë pleh.

— Pa pleh s'ka bukë, — na tha kryetari dhe ngarkoi i pari thesin.

— Po ju? — na pyeti.

— S'kemi thasë . . .

— Kollaj, — tha ai dhe hoqi mushamanë e tij prej meshini. — Mbusheni!

Kjo i çuditi më shumë njerëzit dhe vrapuan të merrnin thasë.

Karvani u bë i gjatë. I mbushëm arat me pleh. I prashitetëm dhe i vaditëm mirë. Misri, gruri dhe patatja u bënë si asnjë herë. Viti i parë që Temani prodhonte bukën vetë, që thyente legjendat e skamjes. Me kryetar Polon u bëmë miq» . . .

Përsëri ecim krah për krah. Ai flet pak dhe gjithënjë për punët e stinës, për plugimet dhe ko-hën: «Lulediellin e filluam mirë, kurse patatja . . . Jemi prapa. Duhet mbjellë e gjitha në gropë. Kemi shumë punë komunale në fshat. Çështja e elektrifikimit duhet shpejtar . . . E ku s'shkon mëndja? Duhet të prodrojmë 30 mijë kuintalë drithra buke. Duhet të realizojmë që sivjet rendimentet e planifikuara për vitin 1970. Për vete na duhen 8000 kv., kurse 22 mijë do t'ja shesim shtetit te prica. Temani ishte ekonomi e vogël, kurse Poshnja . . . Shiko që ku shtrihet! — thotë. — Skrevana, Vokopola, Çifliku, — tregon me dorë. — Koha po mban mirë. Por kohës s'i besojmë shumë ne, — thotë. — Duhen marrë masa që me çdo kohë të marrim rendimentet e planifikuara».

Ecin përmes rrugëve të ngushta edhe kooperativistë të tjerë.

— Shoku kryetar! — është një meso burrë, i shtrëngon dorën.

— Tungjatjeta!

— Do të kthehi, në zyrë?

— Kiske ndonjë punë? Na fal dy minuta. Të dy hiqen në anë të rrugës.

«Ka respekt të madh për njerëzit, — m'u zgjuan përséri në kujtesë fjalët e kooperativistit nga Temani. — Do t'ju tregoj për ditën që u nda nga ne. Ishte mesditë. Ne temanakët ishim mbledhur para kryesisë. Kishin dalë burra e gra. Fëmijët e donin akoma më shumë Polon. Deshi të ndahej aty me ne. Na uroi shëndet dhe punë të mbarë. Ne e përcuallëm të gjithë deri në krye të fshatit. Ai është njeri i dashur, gojëmjaltë. E do punën dhe me punën e tij të bën për vete. I thamë:

— Mos na harro.

Dhe ai s'na ka harruar. Vjen nganjëherë tek ne».

— Tungjatjeta! — përshëndeti kooperativisti që e kish ndalur në rrugë dhe iku i çiltër.

— Ç't'i bësh, kanë nevoja njerëzit. Vinë në zyre, shpesh të takojnë në mes të arës ...

Ai vazhdon të flasë për njerëzit, shokët e tij të arave, për diellin që djeg, për tokën që duket se ka rritur frymëmarrjen.

— Vërë veshin në tokë — a s'dëgjon një farë zëri si frymëmarrje? Tani në pranverë toka zgjohet nga gjumi. Është e ngrohtë si bukvale. — Dhe ulet ngadalë e mbush grushtin më dhe nga arat e pluguara.

«Kanë të drejtë që e quajnë «njeri të arave» Polon, — thashë me vete. — Nga mëngjezi në mesnatë u bie atyre kryq e tërthor. Gjithënjë midis njerëzve. Çdo ditë bashkë me njerëzit. Ç'më thosh tjetër ai kooperativisti nga Temani për të?

«Ishtë kohë fushate dhe ishin lodhur tërë ditën nga puna. Kishim dalë nga parcelat dhe ishim futur në rrugët e fshatit. E ftuam të vinte edhe kryetari me ne. «Jo, — tha, — kam punë». Ne menduam se mos shkonte atë natë në familje dhe s'e zgjatëm... Kish marrë një grup të rinjsh dhe tërë natën kish ngarkuar maqinat me grurë. Të nesërmen i thamë:

— Pse kështu, shoku kryetar?!

— Ju ishit lodhur, — tha ai. — Me ne të rinjtë është më ndryshe.

Ta ha zemrën me punë, është njeri i çuditshëm».

— Janë njerëz të mrekullueshëm, — thotë njeriu i arave. — Bile mund t'i quaj heronj të fushës. Ata mund të bëjnë çudira po t'i drejtosh mirë.

E kuqtoj. Për vete s'më tha asnjë fjalë. Kuptoj se është me shpirt të gjërë si arat, bujar si arat. Po për të flasin kooperativistët. Ai fshatari plak më thosh:

«Netë të tjera. Pellgjet dhe arat krridhen në qetësi. Ndihen vetëm hapat e rojes së kooperativës dhe kënga e buikthit. Në dhomë faqe libri që çfletosen. Trokas në dritare dhe i them:

— Fli, bir.

Ai më fton për kafe. Ka shumë libra, megjithëse shkollën e lartë e ka mbaruar. Jep ca provime të tjera, s'di se përse... Pasi pimë kafe në mesnatë, i them përsëri:

— Fli. Dhe i shuaj dritën».

«Edhe shok i mirë e i shkolluar, edhe bujk i mirë kryetari ynë, — thonë në Poshnjë.

BRIGADA «SHKURTE PAL VATA» E TË REJAVE RROBAQEPESE TË NISHRG-2 TË TIRANËS VENDOSI TË SHKOJË 1 VIT NË FSHAT

Ne jemi dhjetë të reja, punëtore në ndërmarrjen e rrobave të gatëshme Nr. 2 në Tiranë. Stazhi ynë në punë lëviz nga dy muaj në dy vjet, kurse mosha nga 15 vjet, deri në 20 vjet. Jemi të reja në moshë dhe në profesion, por kjo nuk na ka penguar të marrim një vendim të guximshëm; të dallim vullnetare për në fshat, ku, për një vit, të derdhim djersën së bashku me mijëra punëtorë, për të shpënë në çdo skaj dritën elektrike, për të dhënë kontributin tonë të vogël në realizimin e këtij programi madhështor e historik të Partisë.

Çfarë na shtyu ne të marrim një vendim të tillë, të lemë familjet tona dhe të shkojmë në fshat? Kjo është e lidhur ngushtë me frymën revolucionare që sundon në klasën punëtore, patriotizmin e lartë dhe solidaritetin e madh që manifestohet kudo në vendin tonë. Ne jemi rrobaqepëse. Në organizatën tonë profesionale u punua vendimi i plenumit të K.Q. të Partisë për elektrifikimin e krejt fshatrave të vendit, deri më 8 nëntor të vitit 1971,

në ditën e 30 vjetorit të themelimit të Partisë. Ky është një hap gjigand që bën vendi ynë, nën udhëheqjen e Partisë. Pasi u punua vendimi, ne nisëm punën sejçila pranë maqinës së vet; punonim dhe mëndjen e kishim te vendimi për elektrifikimin e krejt fshatrave, 14 vjet përpëra afatit. Një ritëm i pa parë! Dhe sejçila i bëri pyetjen vehtes: Po unë çfarë duhet të bëj për të vënët në jetë këtë program? A jam unë në frontin e punës më të vështirë, atje ku na thërret Partia?

Ne jemi të reja. Lirinë dhe jetën e gëzueshme na e solli Partia, baballarët tanë, vëllezërit dhe motrat tona më të rritura, që luftuan me armë në dorë. Ata patën për strehë bjeshkët e vendit tonë, fshatrat që shtrihen rrëzë këtyre maleve. Partia vendosi në këto anë të shpjeri më shpejt dritën elektrike, kulturën; këtu do të krijohet ashtu si dje një front tjetër lufte. A nuk na takon ne vajzave të reja të shkojmë në këtë front pune e përpjekjesh dhe të punojmë për të shpurë atje dritën elektrike? Në fillim Tefta, pastaj Vjollca, Shpresa morën vendimin të shkojnë e të punojnë një vit në fshat. Këtë e përkrahën të gjithë. Diçka e çuditëshme! Ne jemi rrobaqepëse dhe shkojmë vullnetare për të punuar për elektrifikimin. Dikush nuk do të na kuptojë. Por ne jemi të reja, sejçila nga ne ka kulturën e përgjithshme, vullnetin e dëshirën për të zotëruar në një kohë sa më të shkurtër profesionin e ri të elektricistit. Që tani ne kemi filluar të dashurohem me këtë profesion, të mendojmë për të.

Prindërit tanë, në pjesën më të madhe kanë ardhur nga fshati. Ne jemi lindur e rritur këtu në qytet. Nuk e kemi parë asnjëherë llampën me vajguri. Por atje në fshat, ku janë lindur, rritur e ka-

në luftuar baballarët e nënët tonë, përdoret llampa me vajguri. A nuk na takon ne të punojmë për të shpënë në këto fshatra llampën elektrike?

Brigada jonë mban emërin e komunistes 15-vjeçare «Shkurte Pal Vata». Shkurta zbriti nga bjeshkët në fushë dhe dha jetën në trasenë e heku-rudhës. Shëmbulli i saj na udhëheq, na frymëzon në punën tonë të përditëshme.

Inisiativën tonë ne e muarëm në qendrën e punës dhe kur e biseduam me prindërit, ata na përkrahën, por midis tyre pati ndonjë që na vuri përballë vështirësitë e shumta të fshatit, ndonjë shoqe na kujtoi bulevardin, por ne nuk u tërhoqëm, luf-tuam kundër këtyre koncepteve dhe kuptimit të ngushtë të jetës dhe fituam ne. Ne jemi të vendosura të shpiem deri në fund fjalën e dhënë, të ecim me guxim e kurajo në këtë rrugë.

Pranë fletë-rrufesë sonë, u radhitën shumë shpejt dy fletë-rrufe të tjera. Përbajtja e tyre është revolucionare. Anëtarët e dy brigadave marrin përsipër, që gjatë mungesës tonë, të realizojnë planin edhe të brigadës sonë, të rritin rendimentin, të thyejnë normat ekzistuese, të punojnë më shpejt, dhe më mirë. Inisiativa e këtyre brigadave na gjëzon, na jep forca dhe krahë të punojmë më shumë dhe më me këmbëngulje në frontin e ri të drithës.

*Anëtarët e brigadës «Shkurte Pal Vata»
të NISHRG Nr. 2 Tiranë*

B A R D H A

Dita po thyhej dhe qelli i ngjante një pëlhere në ngjyrë të hirit që vënde vënde i ka dalë boja. Ca re të murme ndiqnin shoqja shoqen dhe nga an' e perëndimit po ngjythesin me të kuq.

Një vajzë e re, e panjohur atyre anëve, po hynte në fshat. Mbante në dorë një valixhe dërrase që dëndur e më dëndur e kalonte nga njëra dorë në tjetrën dhe vështrimi i saj po përpinte me kure-shtje gjithçka që shihte për rrëth. I bënин përshtypje shtëpitë prej guri ngjeshur njëra pas tjetrës, muret ku ishin varur vargje duhan e pipere të kuqe, rrugët e ngushta me bar për anash dhe kumbullat e egra që, të ngarkuara rëndë, vareshin gjer përmbi rrugë. Gurët e udhëve ishin kruar e lëmuar nga zinxhirat e traktorëve, aty këtu ndihe-shin zhurmat e xhullirave që rrihnin bulmetin dhe, për çudi, nëpër fshat, kish fare pak njerëz. Por Bardha e mori me mënd se ishte kohë pune dhe, medoemos, njerëzia ishin derdhur arave dhe fushave. Vajza akoma po nanuriste ëndërrat e veta dhe përfytyronte se në këtë apo në atë shtëpi do priste fëmijën e parë, në atë më tutje do ta thërrisinin mu në mes të natës: «Mami, o shoqja mami, shpejt

se nusen e Likos e kapën tē prerat!». Në atë shtëpinë përfundi rrugës, do ta zgjidhnin edhe pér nune dhe Bardha do ti vinte emrin e parë: «Gëzime! Të rrojë sa malet!».

Vajza qëndroi diku në mes tē fshatit, afër një pusi. Mbi plloçat afër tij po trokiste këmbët një kalë dori që pinte ujë në postaf duke u gëlltitur me gillënka tē mëdha. Mbi pus ishte një arrë e madhe me hije tē rëndë dhe nën hijen e saja rrinin tri plaka. Ato çukitën kokat me njëra tjetrën kur panë vajzën e re dhe tē panjohur dhe diçka mërmëritën midis tyre.

Bardha u foli dhe u dha dorën tē trijave, por ato s'deshën ta lënë tē ikë pa marrë vesh më parë cila ishte, pér ku ishte nisur, prej nga vinte dhe përse vinte. Vajza e re u tregoi dhe ato ja ngulën vështrimin në sytë e saj ngjyrë lajthije dhe në fytyrën e freskët që sapo ishte përcëlluar nga dielli.

— Po ti çupërlinë do tē ndihmosh nuset tonë?

Bardhës iu duk sikur i hodhën në gushë një kovë me ujë nga tē pusit aty pranë.

— C'ka pér tu çuditur këtu moj gjysheni... unë jam mami, kam mësuar kaq vjetë në shkollë, më kanë dërguar tek juve.

— Po ti moj bijë ke lindur vetë ndonjë herë?

— Unë?

Asaj i mori zjarr fytyra dhe i pëcërrroi sytë:

— ...po unë jam vajzë...

— E ... po kur je vajzë, c'do atëhere? S'e di t'i se ajo që s'ka gatuar kulaç ndonjë herë ...

Vajza nuk dintë se çfarë t'u përgjigjej dhe ngriti supet.

Në shtëpinë e Ganiut e pritën mirë. Në oborr dolën dy nuse me fëmijët e vegjël në krahë, bile njëra që i jepte gji foshnjës me njëren dorë shtrëngoi vajzën, kurse krahun tjetër e hodhi mbi qafë të Bardhës:

— Mirësenaerdhe dhe me këmbë të mbarë!

U ngjitën lart në odën e zjarrit. Nëpër qoshet e tavanit kishin varur kokra mollësh kurse mbi buhare kishin vendosur tre katër forma të bukura të gërshetuara me kallinj gruri. Bardha e dëgjoi të zihej në gojë emri «Tixhe», kuptoi se ajo ishte vajzë e shtëpisë, mori me mënd që emëri i Tixhes zihej në gojë duke parashikuar se Tixheja do të ishte shoqë, shoqëronjëse apo moshatare me Bardhën. Por si dukej Tixheja ishte larg.

— Po cila është kjo Tixhe, guxoi dhe pyeti Bardha.

— Kunata e jonë, është goxha çupë, do ta kesh krah, sot shkuan larg me brigadën e tretë, në arat e malit.

Me ardhjen e natës u bë më fresk, pastaj ajri u ftoh dhe padashur Bardha fërgëlli dhe i shkuan të ngjethura.

Malësi këtu, — foli njëra nga nuset, — gusht e gunë ...

Dhe qeshi sa ju bënë dy gropëza ndër faqet. Por nusja tjetër, ajo m'e holla dhe që mbante një çember të kuq në kokë, i lëshoi kunatës edhe fëmijën e saj dhe rendi tatëpjetë shkallëve. E ulur mbi një minder leshi me një jastëk të gjatë e të trashë në shpinë, Bardha mori fëmijën e dytë dhe e mbajti në prehër. Ishte një djalë shtatë a tetë muajsh, me flokë gështenjë të çelur, me një fyty-

rë të trëndafiltë e të ndriçme dhe me një palë sy aqë të bukur sa nusja u shqetësua:

— ... i ka të bukur shumë, mos ma merr për keq por ... thuaj mashalla ... Ngjet nga fisi i sime kunate. Ata i kanë sytë mavi, por ky i ka më shumë se andej...

— Është njomzak, është akoma në sisë, kur të rritet nuk do t'i ketë kaqë mavi, po i ka shumë të bukur, shumë.

Bardha ndehu përparrë djalin e vogël dhë ja vështroi sytë nga një largësi e madhe. Por befas diçka u kujtua:

— Edhe juve e paskeni vajzën si tufë lule ...

Bardha do fliste akoma kur u dha në derë e kunita me teneqenë e madhe të furrës ndër duar. E kishte të mbushur plot me prush. U ul më gjunjë te vatra, derdhi në kllanik thëngjijtë e kuq dhe trazoi urët me mashë.

Poshtë ndiheshin çape burrash dhe copëza bisede:

— Nga ishe ti sot?

— Vadita patatet te Pérroi i madh.

— Vaitin e kafshoi një grerë.

— Fërkojani vendin me uthull.

— Tixhja do vonohet, shkuan për mbledhje në sektorin e Dëllinjës.

Dhe pasi hëngri darkë me nuset e shtëpisë dhe pasi priti më kot të dukej në odë ndonjëri nga burrat e shtëpisë, dhe pasi kot e më kot priti Tixhen e panjohur, Bardhës iu afrua gjumi. Zu kotej dëndur, kaqë herë fërkoi tëmthat dhe faqet me duar, kaqë herë u mundua të mundë gjumin, por s'ja arriti dot. Nuset e reja sollën aty një jatak, shtruan çerga, një jorgan që dukej fare i ri, i uruan natën e mirë dhe shkuan.

Por vajzës tashti iu duk sikur gjumi iu largua dhe përsëri filloi të ëndërrojë: I dukej sikur rrëth vehtes saja silleshin nuse të reja që i kërkonin kë-shilla, ndonjëra s'ishte e sigurtë dhe me gishtat e duarve nëmëronte ditë e javë ... Ëndërronte vëh-ten e saj të gëzuar kur jepte sihariqin: «Çupë e bukur, si lum ju, të na rrojë! Djalë! Djalë! Do të bëhet trim dhe i fortë!».

Dhe ëndërrimi i saj vazhdoi akoma dhe ajo nuk e kuptoi dot kur mbaroi ëndërrimi me sy të zgjuar dhe kur filloi ëndërrimi me sy të mbyllur dhe e thelluar në gjumë.

Kur u zgjua, dita ishte hapur fare. Nuk e kuptoi nëse u zgjua vetiu, apo ishin disa çape të drojtur që silleshin në tremën e madhe të shtëpisë. Pastaj mendeshet e derës kërkëlitën lehtë dhe kana-ta u hap fare pak. Nëpër atë, si shirit të gjatë e të ngushtë Bardha dalloj një palë sy të butë e të zes, pastaj një gërshet të trashë varur përpëra, u çelën një palë buzë në një fytyrë zeshkane dhe një zë i panjohur:

Mirëmëngjez shoqe!

Bardha këceu nga rrobat dhe prej vetiu rrë-mbeu fustanin e vet në fron afër dhe e vuri parzmë si për tu mbuluar po nuk pa njeri tjetër mbas vajzës, lëshoi fustanin për tokë dhe ndehu para duart ashtu si po bënte Tixhja.

Mirëmëngjez Tixhe, ti duhet të jesh më solën shumë për ty.

* * *

Ndryshe e pat menduar Bardha punën e saj, krejt ndryshe pat ëndërruar fillimin dhe tashti po

i delte përpara një çështje e papritur. Ajo s'i mbushi dot dy ditë në shtëpinë e Tixhes dhe me gjithëse njerëzit e atyshëm mundoheshin të fshiheshin prej saj, Bardha e kuptoi se përbrënda asaj familjeje po zjente dhe shtjellohej një sherr i vërtetë. Brënda dy ditëve Bardha mësoi çka ndodhete dhe tashti i dukej sikur ishte njohur me Tixhen që prej më shumë se një viti. Vajza e re i tregoi se desh-nin ta celebrojnë martesën e saj me një njeri që ajo vërtet e kishte parë dy tri herë, por që e kishin fejuar që të vogël. Ai nuk ishte një njeri, i keq, bile ishte shumë i mirë, po ja që Tixhes nuk i pëlgente dhe ky mospëlqim ndofta e kishte rrënjën te fakti se Tixhes i pat hyrë në zemër një djalë i ri aty në fshatin e saj, i pat hyrë në zemër Qemali i lagjes m'at'anë, ai Qemali korozi e mu-staqe-spicë që kur e lëshonte zërin për këngë në-për ara e nëpër pllaja, dëgjohej gjer brënda në fshat e bile gjer në kthinën e Tizhes vetë.

Dhe ndodhi me Tixhen ajo që tashti nëpër maledisëtë tona ka marrë sërë e radhë. Tixhja, pasi u mundua më kot, t'u kundërshtojë burrave, gjyshit dhe babajt, pasi u mundua më kot të ketë krahun e nuseve, çuçuriti vesh më vesh netë të tëra me Bardhën dhe ja, një mbrëmje kur të gjithë ktheshin nga puna, Tixheja me shatë në krahë nuk u kthyte më në shtëpinë e saj, por shkoi bashkë me Qemalin . . .

Kjo ngjarje i tronditi fort të mykurit e fshatit. Hatixheja kishte thyer edhe ajo disa zakone të vjetra e të mbetur si vargonj mbi kokat e vajzave. Dhe bashkë; më mallkimet e pleqve e të planeve për Tixhen, të tjera mallkime dhe shanjë dëshmin edhe kundër Bardhës.

Bardha u detyrua të ikë nga shtëpija ku bujti që natën e parë dhe shkoi në shtëpinë e re të Tixhes. Por fjalët e të mykurve e ndoqën pas:

— Iku nusja e mori pas edhe vleskën e re!

— Mos e nxitëte ajo e qytetit, Tixheja as bënte çap prej shtëpije!

— Ajo kuçkë do na prishë terezinë e fshatit!

— Sakën se e thërrisni në lindje e në më the të thashë.

— Mos i lëmë nuset në dorë të saj se ajo s'ka haber!

— Në vënd të kërthizës, fëmijëve do tu çajë barkun ose do tu presë kokën!

— Do t'i yshtë vajzat që mos u lajnë këmbët burrave.

Kishte burra dhe djem në fshat që e afronin në bisedë, që flisnin pa të keq me të, kurse Qemali vetë fliste më i shkujdesur:

— Kështu është fillimi shoqe, mos u tremb ti, ka rrjedhur ujë, kanë ndodhur ndryshime të mëdha këtej, të ishte një kohë tjetër, në fshat do kishte krisur pushka, po mos u mërzit, edhe zogu s'e ka të lehtë të ngrejë folenë e vet...

— Po mirë o shoku Qemal, e kuptoj, e di, ke të drejtë, po si t'ja bëj unë? Që kurse erdha kanë ndodhur tri lindje në fshat e në asnjerën nuk më kanë thërritur ...

— E di, e di fare mirë, ne e kemi bërë çështje në organizatë, shokët kanë marrë përsipër dhe në fund të fundit ta thotë Qemali ty, eee më fal shoqja Bardhë, unë do të të thérres ty, do të thérres pa tjetër ...

Bardha uli sytë dhe mërmëroi:

— Ju talleni, shoku Qemal!

— Jo, jo, nuk tallet Qemali, unë flas hapur dhe troç! Dhe një gjë ta dish ti. Njerëzit ta kanë nevojën ty, mos u nxito: kur i zë e lindura gratë, vjerrat dhe kunatat s'dinë nga t'ja mbajnë.

* * *

Por edhe katër lindje të tjera në fshat dhe Bardhën nuk e ftoi njeri.

Tri lindje ajo s'i mësoi dot fare, por të katërtën e mësoi dhe desh të hyjë vetë. Desh por e gjet portën myllur, portën myllur dhe që prapa portës disa vërvhëllima e kanosje prej një zë plake... Bardhës i shkuant lotët për faqe dhe iku tatëpjetë e turpëruar. Sharje të atilla s'kish dëgjuar kurrë në jetën e saj.

Dhe ja sapo mësoi për një lindje të re. Nuk e mësoi veç ajo, por gjithë fshati. Në qetësinë e një nate të zezë vjeshte, Bardhës i ardhri gjer në kthinen e saj klithma e një rënkim i fortë. Dhe pikërisht duke dëgjuar përsëritjen e atij rënkim iu duk sikur ai nuk ishte rënkim por një thirrje, një ftesë, një lutje, një britmë dhe kanosje. I dukej sikur Selineja e varfër me buzët e kafshuara e të gjakosura e shante, e urrente, e quante të pazonjën që nuk dinte të çante terin e natës dhe të thyente illozin e rëndë që plaka i shkonte portës.

Ajo u vesh shpejt e shpejt, ndezi edhe një gazanik që kishte mbi buhare, dhe shkoi te dera ku flinte shoqja e saj:

— Tixhe!

— Urdhëro!

— Vishu dhe eja me mua, Tixhe, të keqen...

Tjetra kuptoi që buzët e Bardhës dridheshin. U vunë në rrugë, iknin tatëpjetë dhe mamija

e re shtërgonte mbi gjoks çantën me veglat e veta. Kishin vendosur të hyjnë pa tjetër gjer te gruaja që përpëlitezë e s'lindëtë dot. Por sa iu afroan shtëpisë vunë re se s'ishte e lehtë të hynin brenda. M'u përpara portës, ulur mbi sofatët e gurtë rrinin burrat e shtëpisë hund e buzë bashkë, nuk flisnin e as pipëtinin, por mbanin kryet ulur.

— Ti Bardhë mos dil, fshihu këtu pas gardhit!

— Jo, nuk fshihem, unë...

— Po ti dëgjomë mua, dale, ti qëndro këtu, dale ta marrim shtruar një herë.

Tixha u dolli shesh burrave:

— U lutem shumë, në mos e ndihmoftë Bardha Selimenë, keq s'ka për ti bërë, le ta thérresim një herë, të marrim një mëndje, pushteti dhe partia që e kanë dërguar... ajo po pret ja, aty...

Por gjyshi i shtëpisë nuk e la të mbarojë:

— Unë s'të le ty të kallësh këmbë ndër ne e jo atë zuskë, hajde shporru mos të ti shoh sytë...

Tixhes i mori zjarr fytyra dhe ja ktheu plakut flakë më flakë. Ajo desh të hapë rrugë, ajo desh të pushojë klithmat e dhëmbjes së Selimesë, ajo desh të thyejë paragjykime dhe mendime të mykura, por plaku me llullën ndër dhëmbë as begeniste ta vështrojë në fytyrë. E përhumbur para një porte që s'desh të hapej, Tixha nuk vuri re se nën pezulet e gurta, andej nga e djathta, një nuse e shtëpisë u hodh e rëndi përpjetë. Nusja pat dëgjuar se Bardha priste atje afër dhe nuk vonoi ta gjejë.

Kur Bardha u dha në derën e lehonës, katër plaka, si katër poçe të zeza po vërtiteshin rrithë Selimesë. Nga buzet i rridhte gjak dhe sytë i ishin zmadhuar. Mbi ballë i qenë shpërndarë flokët ngjyrë gështenjë dhe dukej sikur djersa që i derdhej

sumulla sumulla mbi fytyrën e zbehtë, i rriddhte nga flokët. Mbi fronin afër, Bardha vuri re disa ali-psane, një hajmali të madhe, bile edhe një ikonë kishe. Bardha iu vu punës dhe nuk vonoi dhe fëmija ra. Gratë klithën të tmerruara. E vjerra e Selimesë përpinqte duart mbi gjunjë. Fëmija ishte gjallë, por këtu s'ishte sigurija. Edhe dy fëmijë të tjerë pat lindur kështu Selimeja dhe pas disa çastesh jetë, i kishin vdekur. Duhej vepruar shpejt, rrezik që fëmija të mbytej nga ujrat e tepërtë. Ti-rolet nuk kishte por nxori një gazë dhe ja vuri fëmijës mbi buzë dhe me buzët e saja filloj të thithë ujin. Djersët e Bardhës binin mbi gjoksin e foshnjës, fytyra i kishte marrë zjarr dhe nga të thithurat, Bardhës iu ngritën dy damarë të trashë mbi gushë. Ajo thithë... thithë dhe nëna e mjerë e dërmuar nga lodhja e nga dhëmbjet belbëzoi ngadalë:

— Të keqen motër, shpëtoma....

— E ke vajzë, ua sa vajzë e bukur...

— Le të jetë çfarë të jetë, por shpëtoma...

Tashti Bardha thithë ujë nga foshnja dhe lëshonte mbi të lotë gëzimi. Trupi njomzak filloj të marë ngjyrë rozë, në krye një farë grimacë dhe pastaj një piskamë e gjatë dhe e mprehtë!

Bardhës i shkuat të ngjethura nëpër trup, nëpër këmbë e gjer në thembrat e këmbëve. Ajo e ndjeu vehten të lumtur; më të lumtur se kurrë. Ajo piskamë e mprehtë dhe e fortë do të shëmbëte mendime të mykura, ajo piskamë e fortë do thyente lloza të vjetër portash! Ajo po fitonte. Zgjati dorën te dritarja për të marrë flakonin e vogël, por nga shpejtimi e kapi bashkë me perden. Dhe perdja ra poshtë. Jashtë po zbardhonte. Një rreze drithë po hynte nëpër xham duke lajmëruar ditën e re.

PËRSHKRIM

FITOJNË MBI FURTUNËN

1.

Tek pastronte automatikun, kufitar Skënderi, këndonte lehtas një këngë nga ato të barinjve. Këndonte dhe parafytyronte malësitë e Matit, bjeskët, stanet, kullotat, kopetë. Gjithë atë ditë s'e kishte ndarë mendjen nga tufat e kooperativës, për të cilat shokët i shkruanin se janë të mbara e se ushqim për dimër u kanë siguruar.

— Qenke i gjëzuar, sonte! — iu afroa oficer Nihat, komandanti i postës, duke i hedhur dorën në sup.

— I gjëzuar jam, shoku komandant! — iu përgjegj Skënderi dhe i tregoi për letrën, që i kishin dërguar shokët nga fshati.

Oficer Nihat e dëgjoi me vëmëndje. E përgëzoi për dashurinë, që ndjente për fshatin, ku ishte rritur.

— Tani do të merrni shërbimin, — i ndërrroi rrugë bisedës oficer Nihat, — si ndjehen shokët?

— Si sokola! — u përgjegj Skënderi dhe iu drejtua dy kufitarëve të njësitet: Spiro, Bilbil! A jeni gati për shërbim?...

— Gati! — u përgjegjën të dy thuajse njëzëri.

2.

Dëbora binte dendur. Era e furishme i përleshët flokët e saj, duke i shpërndarë anë e kënd. Dhe gjithë ai rrebesch i ftohtë përplasej në fytyrat e kufitarëve, që, me jaka të ngritura, me kokore të ngjeshura mirë, me automatikë në gadishmëri, ecnin njeri pas tjetrit. Përgjonin në çdo hap.

Ecnin dhe gjurmët e tyre sakaq mbuloheshin nga dëbora.

Skënderi, përgjegjësi i njësitet, printe, por herë pas here sillte kokën pas, u fliste shokëve, u jepte zemër.

Dhe kështu arritën në sektorin e caktuar. Umblodhën kokë më kokë. Përsëritën detyrën e se-cili zu vëndin e duhur.

Njësiti nuk u largua për asnje çast nga sektori i shërbimit. Asnjeri s'hapi gojën të thotë:

— Ftohtë! Ngricë! Të ndrrojmë vend!

Jo! Përkundrazi, mblidhnin téré energjitetë, përqëndronin vëmëndjen në detyrën e shenjtë.

Pasi kryen detyrën, që të tre kufitarët morën rrugën e kthimit. Dëbora kishte çdukur çdo shenjë, s'dukej rrugë gjékundi. Tre kufitarët, pranë njeri tjetrit, ecnin me kujdes.

S'kishin bërë çerek ore udhë nga vend-shërbimi, kur një erë e furishme, ngarkuar me dëborë i shtyu pas disa metra,

— Cikloni! — murmuroi nëpër dhëmbë Skënderi, që ia njihte të keqen kësaj shtërgate dëbore. Por nuk u dha. I zuri krah më krah dy shokët dhe bëri më të djathjtë.

Ecnin! Çizmet futeshin thellë në dëborë, sa me zi i nxirrnin andej. Sa vinte, vazhdimi i udhës bëhej më i vështirë, errësira, dëbora, që vazhdonte, dhe, së fundi cikloni, rrezikonin jetën e shokëve. të njësitet.

Këtë e ndjente çdonjeri nga ata, por s'e shprehte, përkundrazi përpinqej t'u jepte zemër shokëve.

N'atë ciklon, ku mjegulla s'të le të shohësh as shokun që ke pranë, kufitarët luftonin të gjenin patjetër rrugën e kthimit. Desh ranë në një gropë. U zbrapsën. Morën në të djathtë dhe u përpoqën të çajnë përpara. Ja, dhe një e thelluar! Spirua u zhyt në dëborë. Shokët e ndihmuani. Nga forca e tërheqjes çizma ngeli në thellësitë e dëborës. Cikloni vazhdonte. E veshën me ç'kishin këmbën e Spiros, por ish e kotë. Ajo po enjtej. Dy shokët afroan supet. Spiro u mbështet mbi ta. Dhe të tre nisën përsëri të çajnë përpara. Por më kot. Furtuna u bë më e fortë, megjithatë kufitarët nuk u trembën. Njeriu është më i fortë nga natyra, e mund atë. Me këtë bindje vazhdonin të luftonin me tufanin.

Këmbë-këmbë arritën te një prozhëm. U lehtë-sua ca udha. Orientoheshin nga kaçubet, pastaj nga dushqet. Dalëngadalë po hynin në pyll. Tufani dhe lëmshet e ciklonit, aty vinin më dobët.

Shohin një mullar dushku. E arritën! U mbësh-tetën pak. Sytë e kufitarëve dalluan një gropë pak më të mbrojtur nga rrebeshi.

— Ja, aty do tē ngrejmë kaliben sa tē pushojë fortuna! — foli Skënderi.

— Tani jemi jashtë rrezikut tē madh — tha Bilbili.

— Shokët do tē na gjejnë! — foli Spirua.

Dhe aty nën atë mbrojtje prej dushku, në atë rrëzë mali, qëndronin tre djemtë e njësitet kufitar tē Cahanajt. Ata i mbante tē fortë, tē papërkulur ideali i lartë për tē cilin kishin vajtur në ato male, i frymëzonte dhe u jepte zemër fjala e partisë, me tē cilën mëkohen çdo ditë, çdo orë.

Nën atë mburojë tē ftohtë kufitarët sillnin në mendje mësimet e partisë, bisedonin për heroizmin masiv, që karakterizon ditët tonë, pér heroin Adem Reka, pér Muhamet Shehun e Myrteza Kepin, pér fillrojtësin Pjetër Llesh Doda dhe komunisten 15-vjeçare Shkurte Pal Vata. U dukej se ata u jepnин zemër: se ndjenin zërin e trimit Fuat Çela dhe tē shokut tē tyre, Mehmet Elezit, që zuri vendin e vëllait tē vet, Agronit, tē rënë në piramidën kufitare. E forcat u përtëri heshin. Dhe flisnin, duke mundur tē ftohtin e dhëmbjen. Por ama një gjë e kishin tē sigurtë: shokët e tyre me siguri që po i kërkonin: — «Do t'na gjejnë... E përsëri do jemi në mes tyre...»

3.

Komandant Nihatini s'e zinte vendi. Edhe kufitarët e tjerë ishin tē shqetësuar pér fatin e njësitet. Ora kishte kaluar. Po afronte mesnata.

Herë pas here kufitari i shërbimit njoftonte:
— Tufan! Ata s'po duken!

— Duhen marrë masa! — u tha komandanti kufitarëve, që kish pranë.

Të gjithë u hodhën: na lejoni të nisemi për gjurmim!

— Do të shkojmë, por të organizojmë shërbimin. Asnjë sektor, asnjë vend — detyrë, nuk duhet lënë pa kufitarë. Do të dyfishojmë forcat. Disa do të nisen në kërkim të njësitit të humbur, të tjerët në krye të detyrës, foli komendant Nihat.

— Duhet thirrur në ndihmë fshati! — propozoi një djalosh.

— Patjetër! — aprovoi komandantë dhe urdhëroi: të jepet sinjal!

Dhe s'vonoi shumë. Nëpër atë dëborë, tufan e ngricë, gati njëzet kooperativistë, kush me pushkë, e kush me lopatë a spatë në krah, u grumbulluan gati për ndihmë.

U sqarua çdo gjë për detyrën. Kooperativistët u treguan të gatshëm për çdo sakrificë, vetëm të gjenin dhe të shpëtonin njësitin kufitar.

Komandant Nihat cakton 6 kufitarë dhe infermier Xhaferin për kërkim, dhe niset sëbashku me kooperativistët.

Ende natë. Rruga nuk shihet, por vendasit orientohen. Ata të ndarë në grupe kërkojnë, thërrasin në emër kufitarët. Por nuk dëgjohet gjë nga fortona dhe vërvshëllima e erës.

Çajnë dëborën kërkuesit, hapin shtigje me lopatat...

Edhe nga fshati i tejmë, Kishajt, në kërkim është nisur një grup kooperativistësh.

Sa të lidhur janë mes njeri tjetrit kufitarët edhe kooperativistët! Ata i gjenden shoqi shoqit në çdo nevojë. Kooperativistët ndihmojnë kufitarët

në mbrojtjen e kufirit. Dhe nuk ngjet kështu vettëm në Cahanaq, por në çdo skaj kufitar të At-dheut. Në zonat e Kukësit dëshmojnë për këtë sa e sa ngjarje. Në Çajë vetë populli e zuri shkelësin e kufirit; në Orgjost fshatarët lëftuan me diversantët dhe s'i lanë të kryenin misionin e tyre të ndyrë. Xhelal Martini është një shëmbull i gjallë i pjesë-marrjes edhe të pionierëve në mbrojtjen e kufijve të shtrenjtë të mëmëdheut. Por edhe kufitarët ndihmojnë në punët bujqësore, edhe në problemet e tjera të fshatit. Ata u gjuan shumë që sivjet kooperativa e re malore e Cahanaqt, për herë të parë në historinë e fshatit, e siguroi bukën në vend.

Të mbrujtur me këto ndjenja, kooperativistë dhe kufitarë kërkojnë.

Koha ecën! Zbardhi drita! Lindi një ditë e myllur nga retë e ulta, që hidhnin dëborën flok-madhe; një ditë me fortunë e ngrica. Por megjithatë, kërkuesit nuk po binin në gjurmë.

Kërkuesit nuk e humbnin shpresën. U vendos të kërkohej në drejtim të bjeshkëve. Ishte e qartë se tre shokët e njësitet ishin çorientuar. Furtuna, cikloni diku mund t'i ketë hedhur. Andej ishin edhe ca kodra me gropë.

Ashtu bënë. Dhe pas ndonjë gjysmë ore marshimi në atë drejtim u dukën ca gjurmë të thella, mbuluar me dëborë rishtas.

— Të japim sinjal — tha njëri.

E kufitari tjetër veproi.

Heshtje! Vështruan rrëth e qark! Ja nga Hurdhë e Gadhomit u dëgjua një zë! Një thirrje malësorësh. Dhe përsëri një përgjigje e zgjatur...

— Ata janë! tha i sigurtë një kooperativist.

Dhe u nisën në atë drejtim.

Pas disa orësh, komandant Nihat u lidh me telefon me eprorët e tij dhe njoftoi:

«Ngjarje e jashtëzakonshme. Njësiti kufitar i sektorit L, që nga ora 22 e datës 11 janar deri në ora 9 të ditës së sotme, 12 janar humbi. U organizuë kërkimi sëbashku me popullin. U gjetën në një pyll dushku. Gjendje shëndetësore e mirë, me përjashtim të kufitar Spiros të cilit i kanë ngrirë gishtërinjtë e këmbës. Me vig druri u dërgua në spitalin e Krumës dhe iu dha ndihma e shpejtë. Tani apo u paraqit këtu kooperativist Rizai, njëri nga djemtë e fshatit, që ishte me ne në kërkim. Ai, i frymëzuar nga vrulli revolucionar i popullit tonë, nga heroika e ditëve tona, nga shembulli i Adem Rekës, Shkurte Pal Vatës, Fuat Çelës dhe, tani së fundi, nga akti patriotik i Mehmet Elezit, që shkoi të zërë vendin e vëllaut, kufitarit Agron Elezi, të rënë në krye të detyrës, kërkoi ta zëvendësojë kufitarin Spiro gjersa ai të shërohet plotësisht dhe të kthehet në krye të detyrës. Këtë vendim, thotë Rizai, e mora, që kur mbarta në krahë kufitarin me këmbë të ngrirë. Rizai ka shërbyer në kufi në zonat e jugut të Atdheut dhe është i pregetitur, është një djalë i mrekullueshëm . . .».

Dhe përsëri dëgjohen njoftimet telefonike, bisedat:

— Ju flet Kukësi! —
— Alo! Alo! —

Nëpërmjet telave, që dridhen nga akulli e cingrima, njoftohet gjendja e kufitar Spiros që ndodhet i shtruar në spitalin e Kukësit dhe që së shpejti do të dalë i shëruar plotësisht; njoftohet për vazhdimin e punës dhe të jetës me vrull revolucionar në Cahanaq, ku popull e kufitarë punojnë dhe vigjë-lojnë; njoftohet për luftën e madhe, që bëjnë malësorët e Kukësit, që duke mposhtur vështirësitet e mëdha të natyrës, punojnë të plotësojnë detyrat e ditës, detyrat e rëndësishme, shtruar nga Kongresi i 5-të historik i partisë.

USHTARE BESNIKË TË PARTISE

Disa herë me radhë Mehmeti pati vajtur në degën ushtarake të Çorovodës dhe kërkonte që ta mernin ushtar. Shefi nga ana e tij e falënderonte dhe i thoshte se nuk mund të veprojë në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret ushtarake.

Si ishte puna?

Mehmeti, megjithëse kish mbushur moshën për të kryer shërbimin ushtarak, nuk e merrnin ushtar, sepse në familjen e tij, me prindër të moshuar, nuk kishte forcë tjetër krahu për punë. Dhe, sipas ligjeve tona, që janë ligje të popullit, për të ndihmuar popullin, Mehmeti duhej të rrinte pranë prindërve. Por: «A duhet unë të mos shkoj ushtar, a duhet të përfitoj unë në kurriz të mbrojtjes së atdheut, — mendonte ai. — Ushtria është një mburojë e Atdheut. Sa fitore kemi arritur! A do t'i gjëzonim këto, po të mos kishim një ushtri të fortë? Jo, sepse do të qenë turrur «palikarët» për të xhvatatur copa toke, do të qenë gëzuar imperialistët e revizionistët që rrinë me lugë në brez. Po, është e fortë ushtria jonë, sepse është i fortë edhe populli ynë, i kalitur nga partia; është, pra, i fortë edhe Atdheu. Unë, edhe duke qëndruar në fshat, jap

kontributin tim për socializmin dhe mbrojtjen e Atdheut, por dua të vesh roben e ushtarit, sepse kështu më duket se e ndjej më shumë që jam bir i Shqipërisë, bir i partisë, i shokut Enver».

Kështu mendonte ky i ri, i edukuar me një ndjenjë të lartë patriotizmi. Ai e shikonte se me të, ata të degës ushtarake po gabonin. Duhej bërë një përjashtim nga rregulli, nga ligji, kur ishte puna për një dëshirë të tillë. Dhe ky nuk ishte vetëm mendimi i Mehmetit. Edhe i ati i tij, xha Sulua, ishte i një mëndje me të birin; ai, kur e dëgjoi atë që bisedonte me shokët e këshillit popullor të Thérépelist për këtë kërkesë, i tha: «Jo mor bir, jo. Nuk ndahemi ne nga shokët. Mbrojtja e Atdheut dhe ndërtimi i socializmit është llogaritur së bashku me neve. Dakort se ka ligje dhe duhen zbatuar, po ka dhe vullnet, ndjenja, nisiativa. Edhe ne, që jemi pleq, duhet ta ndërtojmë vëndin tonë dhe ta mbrojmë atë. Ne jemi pleq, po s'na mungon asgjë. A mund ta ndalojë njeri Fuat Çelën, që megjithëse pa sy, punon dhe arrin rezultate të mrekullueshme. Ji i vendosur. Sot s'ta aprovuan kërkesën, por mos u zbraps, bir. Unë akoma i kam krahët e fortë. 330 ditëpune bëra në vitin 1967, nga të cilat vetëm 10 muajt e parë bëra 280 ditë pune. Këtë vit e ndjej vehten se do të bëj më shumë punë, se partia na ka përtërirë. Kam qënë i pushkës bir, e do të vazhdoj të jem edhe i punës edhe i pushkës. Të punojmë tokën tonë dhe ta mbrojmë atë, sepse çdo njeriu i takon një pjesë prej saj. Pa merr atë kalemin dhe defterin dhe ulu këtu tek dritarja të të bëj një deklaratë se kështu do të marrin ushtar me siguri. Neve nuk do të anko hemi për asgjë, se kur dola partizan nuk i lashë ndihmës familjes, nuk

i lashë as të siguruar me bukë, por puna e vetë familjes, ndihma e shokëve e miqve, solidariteti vëllazëror, nuk e la familjen time të vdiste nga uria. Tani bukën e marrim të gatuar në furrë, bashkëfshatarët kanë marrë përsipër të na ndërtojnë shtëpi, të gjitha të mirat i kemi.

Mehmeti e shkroi deklaratën, e lexuan dhe rilexuan, pastaj e firmosën. I bënë dhe një letër Ministrit të Mbrojtjes. Shokët në degën ushtarake përsëri nguruan. Mehmeti ishkoi në postë dhe hodhi letrën që i kishte bërë Komitetit Qëndror dhe Ministrit të Mbrojtjes, pastaj u kthye në fshat.

... Më ra rasti të shkoj një ditë në Therepel. Takohem me Mehmetin. Flasim shtruar, e pyesim për bagëtinë, punët në kooperativë, punën me rininë, etj. Ai na përgjigjet thjeshtë:

— More punët shkojnë shumë mirë, të gjithë duan të punojnë, edhe natën si punon Fuati, por veç mua nuk po më plotësohet dëshira për të shkuar ushtar.

— Ti je pa ndihmë në familje.

— E kini gabim. Ndihmën që kemi ne sot nuk e ka askush. Ku ka ndihmë më të fortë se ideo- logjia me të cilën na ka brumosur partia? A nuk ish ajo që i dha drithë Fuat Celës? Mua më vjen turp përpara Fuatit dhe shokëve po të mos shkoj ushtar.

Mehmeti kish të drejtë. Ky kooperativist, ky bari i shtronte problemet drejt.

Po partizanët — thoshte ai, — a pyetën për ndihmë e vështirësi? A nuk ishin ata bij të popullit, barinj, bujq, argatë e punëtorë? Dhe unë bari jam, por bari i pasurisë së përbashkët. O unë, o kush duhet të mbrojë atdheun. Jam i sigurtë se

do të më meret parasysh kërkesa. Jam në pritje, prandaj jam edhe i gëzuar, po dhe i çqetësuar.

Pastaj ai hapi çantën, dhe pasi nxori q'andej raportet e shokut Enver, mbajtur në Kongresin e 5-të të partisë dhe në atë të Frontit Demokratik, na tha:

— Çdo shtëpi dhe çdo njeri këto mësime të mëdha duhet t'i ketë. Këto të bëjnë të kuptosh edhe më thellë detyrat që të ngarkohen. Tani po e thyejmë krejt mendimin që kishim se studimi i materialeve të partisë është vetëm për inteligjençen. Ne duhet të studojmë, dhe po i studojmë sa më mirë ato.

Ja, ku e merr forcën, mendimin e kthjelltë revolucionar, ky bari i thjeshtë i Skraparit. Ai, në mësimet e partisë, gjen burimin e pastër për forcë dhe mendim revolucionar, për patriotizëm dhe at-dhedashuri. Dhe ai nuk është i vetëm. Janë me mijra bij e bija që çajnë përpara me këto mësime. Ademi i tillë ishte, Shkurta, Hekurani, Myrtezai, Hyseni, Agroni dhe Mehmet Elezi që zuri vendin e vëllait. Mësimet e partisë i kishin mësime të zemrës së tyre, ishin mësime që ata me gjak i vunë në jetë.

* * *

Kur hymë në shtëpinë e Mehmetit pamë se ajo ishte e mbushur plot me miq. Të gjithë ishin të gëzuar. Lexonin dhe rilexonin letrën e përgjigjes që shkruante Ministri i Mbrojtjes dhe me të cilën plotësohej kërkesa e Mehmetit për t'u futur në radhët e ushtarëve të Republikës. Mehmeti shkëlqente nga gëzimi. Në shtëpinë e xha Sulos

ndjehej një ambjent feste. Ngrihen dolli për partinë dhe shokun Enver. Oshëtuan urimet më të mira për ushtrinë tonë heroike.

Xha Sulua u ngrit e tha:

— Ti drejtojmë një letër shokut Enver, ta falenderojmë për këtë nder të madh që iu bë familjes sonë, fshatit tonë.

Dhe ata e shkruan letrën. Ë shkruan me fjalët më të ngrrohta e më të thjeshta.

«Sa për ne pleqtë, që mbetëm këtu në fshat, — i shkruajnë ata udhëheqësit të dashur — mund t'ju themi me bindje të mos na i kini qederin. Ne ju japim fjalën se sâ të kemi këmbën e dorën, dhe sa të na rrahë zemra, do të punojmë pa përtim për forcimin e ekonomisë së kooperativës. Askush të mos na e ketë frikën se mos mbetemi keq. Kur shohim që punon Fuati i verbër, kur mijra vullnetarë nga të gjitha anët e vendit shkuan në Dibër e Librazhd për të ndihmuar vellezërit tanë që u démtuan nga tërmeti, kur Anifeja shkoi të zëvëndësojë burrin e saj, ne i shtruam vetes detyrën që të punojmë me atë fuqi që kemi për ta përmirësuar gjendjen ekonomike të familjes sonë e mund t'ju themi që kur të kthehet djali ynë nga ushtria, do të na gjejë në shtëpi jo me llambën e vajgurit, por me drithë elektrike e me radio, me anën e së cilës do të dëgjojmë mësimet e partisë dhe tuajat, shoku Enver».

«Në ju japim fjalën se do të jemi ushtarë besnikë të partisë, do të punojmë dhe do të vigjilojmë për të dhënë edhe neve kontributin tonë të vogël sado që jemi pleq».

AI U KTHYE TË PUNOJË PËRGJITHMONE NË FSHAT

Mësimet e partisë hyjnë thellë në mëndjet dhe zemrat e njerëzve tanë, i edukojnë ata me dashurinë e pakufishme për popullin, Atdheun dhe socializmin, rritin gatishmërinë e tyre për të menduar e punuar kudo dhe kurdoherë si revolucionarë. Kudhra e partisë kalit të tillë njerëz, që vënë mbi gjithëçka interesat e larta të popullit, që kërkojnë me këmbëngulje për të shkuar atje; ku puna e tyre është më e nevojëshme.

— 1 —

Në Hormovë të rrethit të Tepelenës, vazhdon puna për të përfunduar historikun e fshatit. Për të ndihmuar kanë ardhur edhe disa djem të fshatit, që punojnë në qytete të ndryshme të vendit. Dikush ka jetuar e ka marrë pjesë në shumë ngjarje të Luftës Nacional-Çlirimtare, dikush ka çfletuar dokumenta të ndryshme historike, që bëjnë fjalë për historinë e Hormovës. Midis tyre është edhe Idajeti. Ai kalon nga një shtëpi e fshatit në tjetrën, bisedon

me pleqtë, interesohet për ndonjë legjendë, mbledh këngë të lashta dhe mban shënimë mbas çdo bisede, që bën me njerëzit. Me këto, ai do të plotësojë historikun e fshatit, por shpesh e ndërpresin në punën e tij: fshatarët kanë nevojë për ndihmës-mjekun.

— Nënë Nurka është e sëmurë, — i thotë një fëmijë, të lutem ejani pak tek ne.

— Ja, erdha. — përgjigjet ndihmës-mjeku, dhe menjëherë e lë punën e filluar për ta vazhduar më vonë. Idajeti, ashtu i papërtuar, shkon kudo që e thërresin dhe jep ndihmën e tij. Nënët e reja thonë fjalë të mira për këshillat që u jep ai për fëmijët, urime të përzemërtë dalin nga goja e plakave për «këtë deli djalë që partia i ka hapur sytë, e ka edukuar me frymë të lartë që t'u shërbejë sa më mirë njerëzve».

— 2 —

Në qendër të fshatit është mbledhur i madh dhe i vogël. Ata mbasi dëgjuan më vemendje gjithëçka, që është shkruar në historikun e fshatit, japid mendime, bëjnë koregjime, shtojnë fakte të reja për të pasuruar atë. Të rinjtë ndjekin më vemendje atëçka thuhet për fshatin e tyre. Historiku i Hormovës, ashtu sikurse i çdo fshati në vendin tonë, është një pjesë e vogël e historisë së lavdishme të popullit tonë. Ata e ndjejnë veten krenarë për prindërit e tyre, që me armë në dorë kanë pritur dhe kanë luftuar kundër shovinistëve grekë, fashistëve italiyanë dhe gjermanë, të cilët me zjarr e hekur deshën të robëronin popullin tonë, Krenar është edhe oficeri i ri i Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme, Idajeti.

Prandaj, sa mbaron diskutimi i historikut, kur hormovitët flasin për luftën, që bëhet për të ndërtuar jetën e re socialiste, edhe këtu rrëzë Golikut ngrihet Idajeti.

— U jap fjalën, të dashur vëllezër, se do të vij përgjithmonë të jetoj e të punoj midis jush, sëbashku me gruan time. Ju kini nevojë për një ndihmës mjek dhe për një infermiere. Gruaja ime ka disa vjet, që ushtron profesionin e infermierës, në qytetin e Tiranës, këtej e tutje le ta ushtrojë në Hormovë.

— 3 —

Idajeti u kthye në Tiranë, por nuk e harroi premtimin e dhënë. Menjëherë kërkoi që të lejohej për t'u kthyer në fshatin e tij të lindjes, nga ku ishte larguar 24 vjet më parë, kur fshati u dogj nga okupatorët. Atëherë Tekiu i ati i tij, mori familjen dhe, duke e bërë rrugën më këmbë, u vendos në Fier.

Duke biseduar me gruan e tij, Xhevон, e cila u gjend menjëherë e gatëshme për të shkuar sëbashku me burrin e saj në Hormovën e largët, sepse kështu na mëson partia, ai kujtoi edhe njëherë të kaluarën e tij; kujtoi kohën, kur i ati punonte punëtor tek një pronar punishteje, dhe nga që nuk mund të përballonte nevojat e familjes u detyrua ta pajtonte Idajetin ysmeqar.

Po vendi u çlirua, dhe për Idajetin e vogël u çelen të gjitha rrugët. Ai ndoqi shkollën për disa vjet, pastaj një vit kurs dhe u bë infermier. I ndërgjegjëshëm në shërbimin ndaj popullit, atij iu be-

suan detyra të ndryshme në këtë sektor deri në inspektor e shef shëndetësie në Kavajë.

Pas mbarimit të shërbimit ushtarak, ndoqi shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendëshme, u bë oficer dhe u vendos me punë në Tiranë ku edhe u martua. Por Hormova kish nevojë për kundro, për ndihmës mjek. Kjo mjaftoi që ndihmës mjeku ta braktisë rehatin, të lejë Tiranën dhe të kthehet në fshatin e tij të lindjes. Kur di sepse jeton dhe punon, edhe në një fshat të largët si Hormova, mund ta ndërtosh jetën të bukur. Komunistët, — thotë Idajeti, — duhet të udhëhiqen nga porositë e shokut Enver, që, kudo dhe kurdoherë të mendojnë për popullin. Dhe vetë kështu veproi.

— 4 —

Hidroçentrali i ndërtuar nga vetë fshatarët e Hormovës, në ditët e thata të verës nuk e furnizonte tërë fshatin me drithë se gurra kishte pak ujë. Por ndihmës mjekut i tërroqi vemendjen një burim uji në afërsi të kanalit, që çonte ujet te hidroçentrali, prandaj një mëngjes herët, mori kazmën dhe filloi punën për të shtuar ujet e hidroçentralit. Porsa e panë Idajetin, rrëmbyen kazmat Çunia, Ramua, Subia, nënë Hankua 60-vjeçare e mjaft të tjerë. Me forca të bashkuara puna u krye. Ujet u shtua, fshati mori përsëri drithë.

Idajeti si komunist, jeton çdo ditë me problemet e fshatit, thellohet në to, merr pjesë aktive në zgjidhjen e tyre. Kështu, kur ai mësoi se midis dy familjeve të fshatit kishte lindur një «mëri» për shkak të një fejese, nuk e zgjati më, sepse nuk i

shérben punës së partisë mendoi ai, por i hyri punës pér t'i pajtuar. Me punë këmbëngulëse e arriti edhe këtë.

Fshatarët e duan dhe e respektojnë; ata e dëgjojnë «doktorin» e tyre të palodhur e të papërtuar. Pér t'i krijuar kushte të favorëshme pune, ata kanë filluar me kohë ndërtimin e ambulancës, të kopështit dhe çerdhes së fëmijëve. Pér të merituar kujdesin, që tregojnë fshatarët, ai punon me këmbëngulje pér të futur të renë në jetën e fshatit. Ndryshimet, që janë bërë në një kohë mjaft të shkurtër, tregojnë edhe pér punën e ndërgjegjëshme që bën ky komunist pér higjenizimin e zbukurimin e fshatit, pér përhapjen e mëtejshme të kulturës sanitare në masat e fshatit.

ELEKTRİCİSTËT ÇAJNË TUFANET E DËBORËS

Për elektriçistët tanimë flitet shumë por është vështirë t'i takosh sepse janë gjithënë në lëvizje. Në Shkodër ra dëborë e madhe dhe i bllokoi rrugët për në veri, kurse në fushat kishin shpërthyer ujrat. Në kushte të tilla ishte shumë e vështirë për elektriçistët që të punonin prandaj shkuam në ndërmarrjen elektrike.

— Deshem të takojmë elektriçist Nikën — thamë.

— Që me natë u nis për në Pecaj të Dukagjinit ... Rrugët janë të bllokuara përmmaqinat, por jo për Nikën. Do të ecë nëpër borë nga tre ose katër ditë.

— Po Xhemali a ndodhet këtu?

— Edhe ky ka shkuar në zonën e Bushatit.

Asnjë nga të 7 elektriçistët që kérkuam nuk ndodheshin aty. Ata e kishin çarë rrëthimin e borës e të ujrave. Sivjet elektriçistët e kësaj ndërmarrjeje do t'u japid drithë 38 fshatrave dhe për të kryer këtë detyrë nuk marrin parasysh asnjë vështirësi, as nuk presin gjersa të përmirësohet koha.

Pas tre ditësh shokët e ndërmarrjes elektrike merrnin herë pas here në telefon Dukagjinin për të pyetur për Nikën; bora ish shumë e madhe dhe ay

akoma nuk kish mundur të arrinte atje. Pa dyshim ay duhej të ndodhej dikund në afërsi; duke çarë tu-fanet e dëborës, për të çuar dritën elektrike edhe në fshatin e Shkurte Pal Vatës.

— Heroizmi i kësaj 15 vjeçare ka fryshtuar edhe këtë burrë që i ka kaluar të pesëdhjetat. Shkurtana fryshtzon të gjithëve në punën tonë — na tha Xhemali, kur më së fundi mundëm ta takojmë.

Biseduam me të. Edhe ay do të niset për në zonën tepër malore të Kelmendit. Jashtë bie borë. Por Xhemali thotë se puna më e bukur është atje ku është më e vështirë. Që i vogël kish dëshirë të bëhej elektricist. Është gjë e madhe t'u japësh dritë njerëzve. Ay «trak» i çelësit elektrik që i mbush shtëpitë me dritë, ta bën jetën më të kënaqëshme.

Xhemali numuron një varg të gjatë fshatrash ku ka bërë piketimet, instalimet e dritave. Ato shtrihen që nga fushat e Nën-Shkodrës gjer në mallet e Dukagjinit. Me mijra njerëz e njojin, e përshëndesin, e ndalojnë për të biseduar. Ai nuk i mban med të gjithë, nuk e di me saktësi se nga ç'fshatra janë, por e di se janë nga ata që ay u ka çuar dritën ndër shtëpia. Askush nuk mund t'i harrojë tiparet e ushtarit të partisë që u çoi dritën në shtëpi.

Gjatë muajve tetor-nëndor 1967 ka instaluar turbinën në Brëglumë të Dukagjinit; ai ka kujtimet më të mira për ata njerëz të etur për dritë. Dukagjiniasit punonin gjithë ditën me Xhemalin për të ndërtuar godinën e hidrocentralit dhe për të vendosur turbinën, dhuratë e punëtorëve shkodranë. Dhe kur në mbrëmje binte çanga, ata vazhdonin të punonin gjer pas mesnate për të mbledhur misrin. Buka dhe drita kanë qenë tëndërrat shekullore të dukagjinave.

Në Breglumë Xhemali i vuri për detyrë vetes t'u mësojë zanatin e elektricistit dy të rinjve fshatarë. Marashi dhe Lulashi janë të rinj shumë të zgjuar e kureshtarë, ashtu si të gjithë Dukagjinisat. Me shpejtësi të çuditëshme mësuan si mirëmbahet rrjeti, si vihen në lëvizje maqineritë, si bëhen instalimet. Marashi me nisiativën e tij bëri instalimet në shtëpi, por kur erdhi puna për lidhjen e kutive, ay kish ngecur...

— Po vij unë, — i tha Xhemali — ajo është punë pak e ngatërruar.

— Ne duhet të ecim me këmbët tonë, prandaj ma spjego si bëhet — nguli këmbë Marashi.

Xhemalit nuk i ndodhej letër aty, por mori një shkop dhe filloj të bëjë në tokë skicën se si lidhen kutitë. Aty kishte edhe plot dukagjinash të tjerë. Pas pak Marashi dhe dukagjinash e tjerë filluan t'i bëjnë instalimet vetë. Prandaj Xhemali nuk u çudit shumë kur pa dritat që ndizeshin njera pas tjetrës nëpër shtëpijat.

Kur u inaugurua hidrocentrali, në Breglumë u bë festë e madhe. Në krye të vendit kishin vënë Pal Vatën dhe elektricistin Xhemal Kraja. Pal Vata kish folur për takimin me shokun Enver dhe për të bijën e tij Shkurtën. Xhemali u kish folur për elektrifikimin.

— Rroftë sa malet partia dhe klasa punëtore!
— kishin thënë Bregumasit.

Kështu do të brohorasin edhe malësorët e Kelmendit në ato ditë kur edhe në fshatrat e tyre do të festohet ardhja e dritave. Edhe kjo zonë është e mbuluar me borë, por kjo nuk është pengesë për luftëtarët e dritës, për Xhemalin dhe shokët e tij që janë të vendosur për të çuar në vend se më parë fjalën e partisë.

NJË NATE NË TUNEL

Në rrugën që zbriste për në hidroçentral u dëgjuat zhurma e maqinës. Mbas pak ajo ndaloi para ofiçinës. Punëtorët që ishin lart u hodhën nga spondet, pa pritur që shoferi të hapte portën. Sejdiu, hyri me vrap në tunel dhe pas pak, u ndodh në sallën e madhe të aggregatëve. U takua me shokun që do t'i mirrte turnin në dorëzim dhe, bashkë me të, shkoi në sallën e komandës. Kur Sejdiu hyri brënda, dy inxhinjerët që po shkëmbenin turnin e përgëzuan që kish mundur të mbyllte, aqë shpejt dhe me zotësi, të çarën e tubacionit.

— Shiko, Sejdin, — foli pastaj inxhinjeri që do të mirrte turnin. Ne e biseduam që ti të mos qëndrosh son te në turn, por të zgresësh me shokët në qytet e të pushosh. Turnin tënd do ta mbajë Avdiu... Ti duhet të çlodhesh se je lodhur shumë me saldimin e tubacionit të çarë.

Sejdiu heshti. Nuk ishte preqatitur për një gjë të tillë. Ç' t'u thoshte? Të pranonte lëshimin që po i bënин shokët?! Dhe përsë? Se kishte mbyllur tubacionin, se kishte punuar disa orë të tepërtë pandërprerje? Po pastaj? E kush nuk do të shkonte

për ta bërë atë punë? Ai i njihet mirë shokët; asnjë s'do të nguronte.

— Faleminderit, por nuk jam i lodhur aqë sa mendoni ju. Do të qëndroj në turnin tim! — u përgjegj Sejdiu ... dhe qëndroi.

Agregatët vazhdonin të ushtonin në thellësi të malit. Aparatet punonin në rregull. Llampat e sinnjalizimeve, si ca sy të vegjël lloj-lloj ngjyrash, tregonin punën normale në të gjithë hidrocentralin: Inxhinjeri, bashkë me elektricistin ndihmës, i vështronin këto herë pas here, shkëmbenin me to dialloge të heshtura dhe diç shënonin në fletoret e trasha që kishin mbi tavolinë. Sejdiu me një shok shkoi në sallën e pompave, në të ndarën tjetër, dhe filloi të nxirrte me kovë ujin që rridhte nga saracineska e dëmtuar; pastaj hynte përsëri brënda dhe çlodhej pranë aggregatëve. Ndërkohë ai shkonte tek inxhinjeri dhe e njoftonte mbi gjëndjen e maqinerive. Hyrjet dhe daljet nga salla e maqinerive, këtë mbrëmje Sejdiu po i bënte më të shpeshta. Inxhinjeri e vuri re këtë dhe e kuptoi shkakun: duke lëvizur shpesh, Sejdiu kërkonte t'i shmangej plogështisë së gjumit, që e mundonte nga lodhja e tepërt. Atij pak nga pak po i mpihesin gjymtyrët.

Për t'u shkundur nga kjo plogështi ai lëvizte rrëth aggregatëve, i prekte me dorë për të parë se mos kishin të dridhura, kontrollonte termometrin, se mos ngrihej temperatura. Pastaj ulej sérish. I hodhi një sy orës. Iu duk sikur akrepët nuk leviznin nga vendi. Koka po i rëndohej. Vendosi brylat mbi tavolinë dhe mbështeti kokën midis dy pëllëmbëve. Dremiti paks. Inxhinjeri e vuri re se Sejdiu nuk po dukej.

«Mos i ka dalë ndonjë e papritur?», mendoi inxhinjeri dhe u ngrit. Hapi derën që i ndante të dy sallat dhe, që në sekondat e para, në vesh iu përplas një zhurmë jo e zakonëshme, një rrapëllimë trokitëse metalesh të rënda, që shoqërohej me vërvshëllimë. «Po kjo, ç'është?», mendoi ai i tronditur. Rendi drejt aggregatit të dytë, që ndodhej më pranë, dhe hipi mbi bazamentin e gjeneratorit. Bazamenti, bashkë me gjeneratorin dhe inxhinjerin që kish hipur mbi të, dridheshin, sikur fërgëllonin nga të ftohtit. Ai kërceu nga bazamenti në dysheme, kaloi pranë kushinetave të degjenradorit dhe vuri dorën mbi to. Dora përsëri iu drodh. Boshti që lidhte turbinën; xhuntën elastike, volantin dhe gjeneratorin, kishte të dridhura të mëdha. Boshti dukej sikur kërkonte të çlirohej nga gjithë ato pesha të rënda dhe mundohej të ngrihej lart. Inxhinjeri e kuptoï difektin; e mori me mend se ç'do të ndodhë, përfytyroi qartë shpërthimin e ujit me një presion prej gjashtëdhjetë atmosferësh, dhe u rënqeth. Por këtë ata nuk do ta lejonin.

— Sejdi! — thirri inxhinjeri.

Sejdiu u përmend. Ç'kish ndodhur në ato sekonda? Përse fytyra e inxhinjerit ishte e ashpër?

— Të ndalet menjëherë aggregati i dytë! — tha inxhinjeri.

Sejdiu shpejtoi dhe bëri manovrime. Mbas pak aggregati, si një përbindësh i mundur, e pushoi klithmën e tij. Kurse volanti, ai masiv metalik prej disa tonësh, kish filluar të hapej më dysh, sikur ta kishte goditur një dorë e fuqishme me një shpatë gjigante.

— Volantit i janë këputur disa vida, që bashkojnë të dy pjesët, — tha inxhinjeri, — dhe po

të mos e kishim kapur me kohë difektin, do të ishin këputur të gjitha vidat: dhe merre me mënd se ç'telashe do të kishim pastaj ...

— Ashtu është ... — pohoi me gjysëm zëri tjetri.

— Ne do të kemi punë me volantin, ... kurse ti shko ... shko e pusho në dhomë ... Ke nevojë të çlodhesh ... Më parë lajmëro ndihmësin të lërë punën me ujin dhe të vijë këtu, të qëndrojë pranë aggregatit, — tha inxhinjeri dhe nxitoi të lajmëronte me telefon brigadën e rimontit që të nisej sa më shpejt.

«S'ma zuri në gojë dremitjen ...», mendoi Sejdiu kur mbeti vetëm. «Apo mos ky nuk është shku-ku që u prish volanti? ... Kjo ndodhi brënda disa sekondave ... Por unë pse u tregova kaqë i dobët?!». Sejdiu e ndjeu vehten në çast të braktisur nga ajo forcë e brëndëshme, që e bën njeriun të mbajë ballin lart. Syulur mori rrugën e tunelit. Duke ecur, i bëhej sikur zëri i inxhinjerit i thërriste nga pas: «Shko, shko! ...».

Doli nga tuneli. Jashtë ishte ftohtë. Kjo e solli më tepër në vehte. Sytë i vajtën tek roja, që diç po matej t'i thoshte. Sejdiu ngriti jakën e palltos dhe shpejtoi hapat. Një fërfëllimë e ftohtë ere i përplasej në fytyrë dhe i dukej se dikush po i priste majat e veshëve me një brisk të akullt. Ngriti edhe më jakën e palltos dhe prapë mendimi, se roja donte t'i thoshte diçka, nuk po i ndahej. «E, ç'do më thosh?!», murmuriti me vehte, «pse u ndal aggregati? I erdhi radha dhe u ndal. E lodhën gjithë këto vjete së punuari; ja sepse! ... Apo mos jam unë shkaktari?! ... Përse nuk e kapa unë

difektin? E vuri re inxhinjeri i pari ... Po unë ç'béra?! ...», grindej me vehte, duke ecur nëpër rrugën që të conte në fjetore.

Sejdiut i dukej sikur nuk ecte me këmbët e veta. Mbi supe i bëhej sikur mbante një peshë të rëndë, që s'e kish provuar ndonjëherë tjetër. Ashtu, u ngjit nëpër shkallët e drunjta të fjetores së punëtorëve dhe, kur u gjend përballë derës, u kujtua se çelsin e dhomës e kishte harruar në sirtarin e tavolinës, në repartin e aggregatëve.

«Jo, atje s'mund të shkoj!», tha me vehte, «nuk i duroj dot vështrimet e shokëve ... Apo më duket mua?!» Pastaj ai deshi t'i jepte pak kurajo vehtes, duke thënë se ajo kish për të ndodhur edhe me cilindo, por mbeti ashtu i stepur në shkallë, i mbështetur tek parmaku. I erdhi turp nga vehtja, kur kujtoi se kishte dremitur ato pak sekonda. Iu duk sikur inxhinjeri po ia përsëriste ato që i tha kur e gjeti të përgjumur. U kujtua se nga turbullimi nuk i kishte thënë ndihmësit të shkonte brënda në tunel. Zbriti shkallët me të shpejtë dhe u gjënd tek hyrja e sallës së pompave. Vështroi brënda, por ndihmësi nuk ishte aty.

«Do ta kenë lajmëruar», mendoi Sejdini. «Po i futem unë kësaj pune ... Unë qëndrova në punë kur çdo gjë shkonte në rregull, e jo më tanë, kur shokët përlëshen me avarinë.... Le të mendojë ç'të dojë inxhinjeri ...», dhe i vrullshëm siç që, hoqi pallton, përveshi mëngët, vështroi për rrëth për galloshet, me të cilat kishte punuar ai tjetri, por ato s'qenë aty. Tjetri duhej t'i kishte marrë me vehte. Zbathi këpucët, përveshi pantallonat dhe u fut në ujë. Në fillim mbërdhinte, por pas pak u mësua. Nisi ta nxjerrë ujin me kovë.

Roja doli nga kalibeja, u afrua dhe nga dritarja e madhe vuri re Sejdiun. Këmbët i qenë mavijosur, por ai s'donte t'ia dinte. Roja tundi nja dy herë koken dhe bëri nga kalibeja... Sejdiu e nxorri të gjithë ujin... mbathi këpucët dhe shkoi në oficinë. U kthyte prej andej me disa çelësa pune në duar dhe filloj të punojë tek saraçineska e dëmtuar. Roja u afrua prapë tek dritarja. Përmes xhamave, në sallën e ndriçuar nga drita e fortë elektrike, ai pa Sejdiun që kësaj here iu duk i përtërirë. Në vënd të kovës, ai punonte me një çelës të madh. Roja tundi prap kokën dhe buzëqeshi.

Në punë e sipër Sejdiut s'i largohej nga mëndja avaria tek aggregati i dytë. Përjashta u dëgjuaboria e fortë e një maqine. Kish arritur brigada e remontit. Sejdiut i shkrepi një mendim: «Do vete edhe unë në tunel me ta» tha: «As që e ndjej lodhjen fare. Le të thonë ç'të duan... E ku rrighet në krevat tani... Inxhinjeri kujdeset përmua, por unë s'qendroj dot shtrirë.. sidomos tani që ndodhi kjo... Nesër le të merren me mua. Sonte do të merrem unë me volantin.

Kur hyri Sejdiu në tunel, brigada e remontit kishte filluar punën. Atij i vajti syri tek volanti që ishte mbërthyer nga hallkat e trasha të zinxhirit të vinçit lëvizës në tavan, që dukej si një shqiponjë e madhe që kish kapur me sqepin e fortë një pre të rëndë. Mjeshtri që drejtonte punimet i shtërngoi dorën Sejdiut.

— Bëre mirë që erdhe, — i tha. — Sonte do na duhesh; kemi punë edhe me saldatrinë tënë. Sejdiu ndjeu se gjaku nisi t'i lëvrinte me shpejtësi dhe u skuq i téri, si atë çast kur inxhinjeri e kish përgëzuar para shokëve përmbylli-

jen e tē çarës së tubacionit; dhe një valë ngrohtësie i përshkoi krahërorin. Shokët po e vështronin fytyrëqeshur. Inxhinjeri i ra lehtë krahëve dhe i tha me shaka:

— Ama, tē pushuar që bëre, o Sejdin!...

— U çlodha mirë! — tha Sejdini buzagas. Endjente vehten si tē lehtësuar nga një barrë e rëndë.

... Në mbrëmje vonë volanti u rregullua ...

VËSHTIRËSITË MPOSHTEN

Atje ku të jetë fronti më i vështirë i punës do të jenë si gjithmonë, të rinxjtë. Kjo është motoja kryesore që karakterizon gjithë veprimitarин e të rinxjve në minierën e Kromit Thekën-Martanesh. Këtë parullë e vërtetojnë plotësisht rastet e shumta të heroizmit që kanë treguar të rinxjtë e kësaj organizate. Është për t'u përmendur i riu Halit, i cili çau furtunën e dimrit, kaloi nëpër malet e Batrës dhe të Verjakut, vetëm për të arritur sa më parë në minierë dhe puna e tij në të të mos ndërpritej. Halit Myrtja është nga fshati Lis i rrëthit të Matit, por u rrit në malet e Kaptinës së bashku me minierën e Theknës. Erdhi në minierë që në moshën 16 vjeçare. Në fillim punoi punëtor transporti dhe brënda një kohe të shkurtër në sajë të punës së mirë që bënte e caktuan brigadier transporti. Mirëpo ky i ri, i pajisur me ideologjinë e partisë, në asnjë mënyrë nuk pranonte të rrinte në një punë të lehtë, prandaj me të mbushur moshën 18 vjeçare, me kërkësën e tij kaloi nga sipërfaqja në nëntokë. Haliti duke u udhëhequr nga parimet se: «interesat e tij janë të pandara nga interesat e shoqërisë në tërësi dhe se çdo punë që i shërben

kolektivit dhe shoqërisë është njëkohësisht dhe puna e tij personale» përqafoi menjëherë profesionin e vështirë të martelistit, të cilin e kryen më së miri.

Duke patur parasysh se duhet të kursejmë sa më shumë dhe të mbështetemi kryesisht në forcat tona, ky i ri revolucionar propozoi që me mbeturinat e marteleve të vjetër, të ndërtonte martelë të aftë për punë. Dikush nuk kishte besim në forcat e tij, por përgjegjësi i minierës, shoku Hajredin, komunist i vjetër, e përkrahu menjëherë këtë propozim. Marteli është material importi, prandaj duhet ta ndërtojmë sa ma parë, kështu mendonte i riu novator. Por ja që të ndërtonte martelin duheshin susta, «flutura», manikota dhe çekiçë goditës të cilët nuk i kishte miniera. Një mëngjez të ftohtë ai niset për në Bulqizë e Batër për të kërkuar pjesët që i mungonin. Shokët e këtyre minierave e ndihmuan vëllazërisht. Por kur ai vendosi të kthehej nga Batra për në minierën e tij, filloi një furtunë e madhe. Minatorët nuk e lanë, por ai nguli këmbë që të nisej mbasi puna duhej përfunduar sa më parë. Ndërsa furtuna po shtohej, novatori nxitonte më tepër. Në orën 14,30 arriti në sektorin e minierës Lug i gjatë. Inxhinieri i sektorit u mundua që ta kthejë, por i riu ka vendosur që me çdo kusht të arrijë në minierën e tij, e cila ka kaq shumë nevojë për të e për martelin që do të ndërtojë. Haliti e kishte të qartë se liqeni i Sopeve ish shumë i vështirë për t'u kaluar, por vullneti i fortë fiton mbi çdo gjë. Fushën e Vervjakut, përvçe furtunës, e kish mbuluar edhe mjegulla dhe dëbora. Rruga nuk dallohej fare. Humbi rrugën e u kthyë 2-3 herë në të njëtin vënd. Duartë nuk i lëviznin, por trastën

me veglat e martelit nuk e lëshonte për tokë. Mblo-dhi edhe një herë forcat për t'u nisur, por këmbët nuk i lëviznin. Në moment sytë i ndritën nga gjëzimi, drejt tij vinin dy punëtorët e stacionit të pom-pimit të ekspeditës gjeologjike Thekën, të cilët qëndruan tek lijeni i Sopeve për të marrë prej andej ujë për sondat e çpimit. Këta dy punëtorë e sollën në sektor dhe e shpëtuan nga vdekja. Të nesërmen, me gjithëse i sëmurë, ai e ndërttoi martelin e parë me mbeturina të vjetra dhe e vuri në punë.

Për këtë të ri nuk ka asnjëherë tetë-orësh të caktuar. Në çdo turn atë e shikon në galeri duke pastruar valvolat e martelëve që bllokohen nga pluhuri, duke grasatuar rrotat e vagonave, duke rregulluar shina ose tuba. Para ca kohësh brigada nr. 1 e prodhimit duhej të punonte me një martel mbasi tuba në «furnelin» e galerisë 12, ishte shpuar. Në orën 22 lajmëruan Halitin. Ai u ngrit dhe vajti për të rregulluar tubin e ajrit, sepse ndryshe plani nuk do të realizohej dhe bombola do të shfrynte ajrin.

Çdo vit, në kohën e verës në minierën e Thek-nës ishte problem uji për motorat. Për këtë, çdo ditë, 3 punëtorë dhe një brigadier duhej të mbushnin fuçia me ujë në përruin që është 3 km. larg minierës, t'i ngarkonin në makinat e parkut të Tiranës dhe t'i sillnin në depozitën e motorave. Kjo metodë pune kishte shumë të mëta si harxhim të tepërt të fuqisë punëtore, furnizimi bëhej jo i rregullt, centrali duhej të punonte në çdo kohë etj. Duke parë të gjitha këto të meta, Hajredini dhe Haliti i propozuan kolektivit që ujin ta marrin nga një vënd 2 km. larg dhe linjën e ujit ta bëjnë më punë vullnetare, me tubat jashtë përdorimit të marrë nga gjeologjia. Linja e ujit u ndërtua në një kohë shu-

më të shkurtër dhe si rezultat i kësaj pune, furnizimi me ujë gjatë gjithë verës ka qënë shumë i mirë. Por dimri i ftohtë bëri që tubat të ngrijnë. Për këtë gjë nuk mund të qëndrojë indiferente organizata e rinisë. Brënda ditës, me anë tubash marrin ujin e sondës dhe e fusin në depozitë. Kështu bëhet e mundur që puna të vazhdojë normalisht. Ndërsa motorat punojnë me ujin e sondës, në anën tjetër të rinxjtë vazhdojnë futjen e tubave në dhé. Në ballë të punës qëndron Haliti.

Ç'I SHEH SYRI, IA BEN DORA

E kush nuk flet mirë pér njeriun e kudhrës, pér mjeshterin 40-vjeçar nga Vunoj i lokalitetit të Himarës! Ai është i vjetër në profesionin e tij si kovaç.

Kovaç? kjo është pak pér atë. Ai ka 7 profsione: kovaç, murator, elektriçist, motorist, marangoz, blegtor dhe kooperativist.

Në vendin e punës së tij qëndron varur parulla: «Më përparimtar është ai që punon, ai që e do punën, sepse vetëm puna mban gjallë shoqërinë dhe e zhvillon njeriun». Një tavolinë me vegla, një furçë e thjeshtë, dhe kudhra, ku ai rreh hekurin e skuqur. Ky është vendi i punës së tij, ku ai derdh djersën bashkë me ndihmësit pér orë të tëra. Ai është i ndërgjegjshëm dhe nuk njeh orar pune. Nga duart e tij të shkathëta furnizohen sot me vegla pune 18 brigada të kooperativës bujqësore të zmadhuar të Himarës, Pilurit dhe 4 brigada të kooperativës «Zaho Koka» të Vunoit. Thodhoriu, njeriu i thjeshtë, me përvojë e vullnet të madh, prodhon kazma, plugje, lopata, kosore, çekanë, etj., e të gjitha këto me punë dore. Prodhet 40 kazma të stomsura dhe të kalitura në ditë, kurse vetëm të ka-

litura 90 copë. Po edhe me plugjet nuk mbetet prapa. Duke patur të ngulitura thellë në mendje dhe zemër fjalët e partisë dhe të shokut Enver, për ta prodhuar bukën në vend, ai tani prodhon plugje me cilësi të lartë. Dikur plugu vetëm 12 ditë shkonte, se toka ishte e fortë, hapeshin toka të reja. Megjithë punën e palodhur të farkëtarit dhe ndihmësve të tij brigadat kishin mungesë plugjesh. Ç'të bënte kovaçi? Natën nuk e zinte gjumi, po mendonte, mendonte dhe thosh: «Po unë çfarë po bëj?

Dhe ja një çuk-çuk dëgjohej në kovaçanën e Thodhoriut edhe pas mesnate. Atij i kishte lindur një ide, që po e provonte në praktikë: plugut që shkonte 12 ditë i vuri një copë çeliku në majë dhe puna i doli me sukses. Tani një plug i tillë bën 60 deri 73 ditëpune, brigadat furnizohen tani si s'ka më mirë.

Kur dikush bisedon me Thodhoriun për këtë ai i flet me «ne».

«Ç'është e vërtetë, thotë ai, pa ndihmën e kollektivit unë nuk mund të bëja asgjë». Të shumta janë rastet kur ai ditën punon në prodhim, hap toka të reja me shokët në Vuno ose mbledh patate dhe pastaj në kovaçane vazhdon të derdhi djersë deri pas mesnate.

Thodhoriu është edhe blektor i mirë. Vitin e kaluar kur u ndje nevoja në kooperativë për çoban, sepse vunjotasit e kishin për turp të kullosnin dhentë, ai i mbrujtur me mësimet e partisë, dhe idetë e saj revolucionare për të luftuar dhe kapérxyer çdo vështirësi, ndërmori edhe këtë nisiativë revolucionare; u ngrit i pari e shkoi çoban, por edhe kovaçanen nuk e la bosh, sepse ndihmësit e tij që ai po u mëson zanatin, e që do t'u lerë stafetën e

kovaçanës në dorë, nuk e turpëruan. Ata bënë punën e ustajt të tyre dhe brigadat nuk u ankuau. Dëshira pér të qenë gjithmonë shërbëtor i ndërgjegjëshëm i popullit e ka bërë Thodhoriu shembull të lartë frymëzimi pér të gjithë anëtarët e kooperativës. Ai ka preqatitur mbi 20 ndihmësa si miratorë, marangozë. Disa, — thotë ai, — edhe më kanë kaluar, ndonjëri është bërë edhe inxhinier. Ama më bëhet qejfi që bashkë me veprat rriten edhe njerzit e rinj pér të cilët ka kaqë nevojë Atdheu ynë, që është kthyer në një kantier të madh ndërtimi.

Këtë vit ay krahas punës po punon pér të nxjerrë edhe një libër pér kovaçët.

— Pa libra, — thotë Thodhoriu, — nuk mund tē jesh kovaç i zoti.

Mësimi, puna, zgjerimi i njohurive dhe thellimi në problemet teknike, pér atë kanë qenë faktorë të domosdoshëm pér ngritjen profesionale. Vendimi i Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të PPSH dhe fjalimi programatik i shokut Enver Hoxha mbi kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor, hapën pér Thodhoriu rrugë të reja. Këto dokumenta me rëndësi historike e shtynë atë që përvojën shumëvjeçare tē mos e mbajë në bilojet e shënimeve, po ta hedhi në letër e ta bëjë pronë tē të gjithëve,

Thodhoriu, njeriu i punës në kovaçanë, ustai që preqatit nxënës, punëtori i thjeshtë në kooperativë, vaditësi i portokallave natën dhe blegtori, është një shembull i mirë edhe në preqatitjen ushtarake. Të gjitha këto, ai i bën sepse i studion me vëmëndje tē madhe dokumentat e partisë. Në kovaçanë tē bie në sy menjëherë dollapi i vogël, por i bukur i bërë nga dora e tij, plot me dokumenta tē partisë dhe fjalime tē shokut Enver.

GJALLERI E RE NË BJESHKËT E VERICHT

Në fshatrat e bukura të bjeshkëve tona të veriut po vërshon gjallëri e re. Vullnetarët po e ngrenë peshë rininë. Lufta kundër jetës së mbyllur e konservatorizmit është puna më e bukur e tyre. Të gjithë kanë të përbashkët një gjë: dëshirën për të mësuar, durimin për të ndihmuar shokun, vëllanë në malësi që të gjithë ta njohin e ta çmojnë me forcën e shpirtit revolucionar jetën tonë të madhe socialiste.

Krahas mohimit të së vjetrës, të tregojmë ç'është e reja

Në kooperativën bujqësore të Arrenit punojnë dy vajza vullnetare nga Gjirokastra. Kooperativistët i njohin këto vajza si luftëtare të palodhura, të thjeshta, të urta, të futura, të cilat «kudo punojnë mirë dhe na mësojnë si duhet të luftojmë çdo gjë të vjetër» — thonë ata.

— Ne erdhëm këtu që të mësojmë, thotë Vitorja.

— Këto vajza na hoqën barrën nga shpina e grave, thotë sekretari i organizatës bazë... dhe tregon:

Në filim të fushatës së mbjelljeve pranverore ne u rrëmbyem nga puna e madhe që na dolli përpara, kështu harruam të imprehim vigjilencën kundër çdo gjëje të keqe që e rrëndon dhe e shëmton jetën e re në kooperativën tonë. Ja përshëmbëll: ne kishim vendosur që të mos lejonim kurrë të ngarkohen gratë në shpinë. Po zakoni na tërhoqi, nevoja na shtyu që për plehun të bëjmë përjashtim. Kështu gratë morën koshat me pleh në shpinë për t'i çuar në ara. Kjo gjë u la përshtypje të keqe vajzave dhe me njiherë i drejtuan kryesisë së kooperativës një propozim të thjeshtë që ne s'na kishte shkuar në mendje: «të bëjmë tezga, thanë. Nuk mund të lejojmë që të shkelim vendimet e partisë!». Komunistëve të organizatës sonë kjo gjë iu duk e pamundur, po shoqet ne na u qepën. Ato filluan vetë punën me tezga. Më vonë edhe gratë e ishatit. Dhe barra u hoq nga kurrizi i nënave e motrave tona.

Akoma: Kush duhet të shkojë vullnetare në jugë?

— I shihje vajzat e papërtuara. Kur bisedonin e rrinin bashkë me gratë në arë, në shtëpi. Kur u shtrua puna e nisjes së vullnetarëve për në jugë, ne menduam se do ta kishim punën shumë të vështirë. Po agitatoret e flakta e kishin zgjidhur vëtë problemin: në organizatë erdhën propozimet nga masa. Dhe ç'farë? Gra e nuse që s'kishin dalë kurrë nga fshati. «Edhe ne duam të shkojmë vullnetare si këto shoqet tona!» thanë ato.

Vullnetarët kanë plane të mira përparrë për të gjallëruar jetën dhe veprimtarinë e organizatës-bazë të rinisë. Për shembull vullnetaret nga Gjirokastra kur shkuan në kooperativën bujqësore të Shëmri-së e gjallëruan organizatën dhe vunë në vend shumë boshllëqe në zbatimin e statutit të BRPSH.

Një mbrëmje që la përshtypje në shtëpinë e malësorit.

Detyrat e tyre shoqërore në fshat vullnetarët i kryejnë mbas pune. Ata nisen nga mësimi i partisë se edukimi duhet t'i shërbejë prodhimit. Në mbrëmje, pas pune në fushë, është mirë dhe e domosdoshme të merresh me probleme që kanë nevojë për zgjidhje.

Atë ditë do të bëhej mbledhja e organizatës së rinisë. Mbledhja që caktuar në mbrëmje. Vullnetarëve u bëri përshtypje fakti që në mbledhje nuk erdhi asnjë shoqe. Pse?

— Është vonë, tha një i ri. Zakonisht ne i bëjmë mbledhjet në mesditë! Nuk i lejojnë prindërit të vijnë vonë në shtëpi!

Vullnetarët akoma s'po e kuptonin këtë gjë, sa perëndon dielli të futesh në shtëpi. Po aktivitetet kulturale kur do të zhvillohen? Ata kujtuan kooperativën e tyre «Roja e kufirit» në jugë të vëndit. Atje zjente mbrëmja nga aktiviteti i rinisë. Edhe këtu duhet bërë një punë e tillë. Me këto mendime të mira në kokë vajzat u drejtuan nga shtëpia ku banonin. Në shkallë ishte varë një llampë me vajguri që ndriçonte. Vajzat trokitën në derë. I ngrysur dolli i zoti i shtëpisë:

— Tjetër herë, tha ai, mos më vini vonë në shtëpi. Nuk është zakoni ynë kështu. Është malësi këtu!

Vajzat buzëqeshën. Kur u ulën rrëth vatrës, nën dritën e llampës vunë re fytyrën e mërzitur të zotit të shtëpisë.

— Së shpejti do të kemi dhe elektrikun, tha njëra nga vullnetaret.

— Rroftë partia, tha i zoti i shtëpisë.

Ai fliste prerë, sikur diçka nuk i pëlqente. Më nё fund u tha:

— Sonde ma prishët qejfin. Nuk duhen bërë mbledhje nё mbrëmje me cuçat!

Vullnetaret e kuptuan pse vajzat e fshatit mungonin nё mbledhjen e rinisë. Ato s'i linte zakoni i jetës së myllur, ky zakon i vjetër. U shtruan nё bisedë pёr këtë çështje dhe i treguan malësorit se këtu ai nuk kishte të drejtë. Njeriu duhet të punoju nё fushë, të zhvillojë aktivitete të ndryshme pas pune pёr të gjallëruar jetën e re. Vajzat ishin optimiste sepse sot nё fshat kanë edhe shoqe vëndase, 30 shoqet e fshatit që u kthyen nga hekurudha.

Atë natë, nё atë shtëpi biseda vazhdoi gjatë. Vajzat e jugut e bindën të zotin e shtëpisë mbi punët e mëdha që duhej të bënte rinia dhe se jeta nё fshat nuk mbyllët nё perëndimin e diellit.

Punë, edukim, shkollë

Një pjesëtar i grupit të vullnetarëve nё kooperativën bujqësore të Zapotit dolli një çerek ore vonë nё punë.

Kooperativistët këtë gjë se vunë re. Mirëpo një shoqe nga vullnetaret propozoi të bëhej një mbledhje e shkurtër për të parë si vete zbatimi i disiplinës në punë.

— Tani që jemi në kulmin e punës në bujqësi, tha ajo, a na lejohet ne që të humbasim minutën? A na e fal këtë gabim klasa punëtore që na ka dërguar këtu pér të qenë në rregull me çdo gjë si në ndërmarrjen ku punonim?

Kooperativistët e kuptuan ku ishte fjala. Njeri u ngrit e tha:

— S'është ndonjë gjë e madhe! Pak u vonua ajo. O hu, po t'i shofim kaq hollë punët!

Po ky mendim nuk u përkrah. Dhe mbledhja e organizatës u bë. Kooperativistët i ngulën sytë te vullnetarja e cila u ngrit të bënte autokritikë, ashtu siç e ka zakon një punëtor i mirë. Kanë kalluar ditë e javë nga ajo ditë! Po kjo la përshtypje të thella te kooperativistët. Më parë kishte jo vetëm nga ata kooperativistë që vinin vonë, po dhe nga ata që mungonin fare në punë dhe brigada nuk çqetësohej aq. Kurse tani, të gjithë dalin në punë, punojnë mirë. Në pushim zhvillojnë biseda të frutshme dhe ndjejnë kënaqësi.

— Po ti, merr rrogë që ke ardhur këtu, e pyeti një kooperativist kandidatin e partisë Petritin.

Ai i tha se ishte vullnetar, vullnetarët nuk marrin rrogë.

— Po a jeni martuar, fëmijë keni, kush i mban?

— Kam dy fëmijë. Punon gruaja, kujdeset koletivi — ju përgjegj vullnetari.

Kooperativisti e pa dhe një herë me habi. Dhe që nga ajo ditë ai rri bashkë me të në punë.

I ka thënë disa herë se edhe atij i ka mbetur merrak që akoma nuk e kanë caktuar vullnetar. Ai është gati të niset ku të jetë nevoja. Atij, gjatë kësaj kohe mund t'i kenë lindur njëqind pyetje, po shëmbulli i njeriut që ka pranë i sqaron të gjitha. Kështu bëhet këtu: punë dhe edukim, një proces i vazhdueshëm, i pandarë. Dhe këtë proces tanë e udhëheq nga afër, drejt për drejt klasa punëtore me anën e komisarëve të saj në fshat.

Vullnetaret nga Durrësi punojnë si anëtare e kooperativës bujqësore të bashkuar Ujmishi. Me ta është dhe Nadirja. Kur pa vajza malet që zbrisnin thikë buzë Drinit dhe arat që vareshin shpatave si qilimë të çuditshëm, kur vështroi tokat e Reskut e të Skavicës, ato toka të pakta që i mbrojnë me një mijë vështirësi njerëzit, që të mos i marë erozioni, ju ngjall një ndjenjë e madhe respektive për këta njerëz të mirë të punës. Mendoi: Sa të fortë i bëri njerëzit partia: preku lehtë me dorë, sikur desh të sigurohej dhe një herë, vendin ku mbante dokumentin e kandidates për anëtare partie.

Pastaj shtoi:

«Kur këta njerëz janë në çdo punë përballë vështirësive më të mëdha, luftojnë e fitojnë, unë si ta bëj me shkollën?» Nadirja është në vitin e tretë të gjimnazit. Dy vitet e para i mbaroi në shkollën e mbrëmjes në Sukth. Po ku është gjimnazi në Skavicë? Mal këndeje mal andej, Drini zhurmon në mes, lart një rrip qelli i gjërë sa shtrati i lumit që zhurmon.

— Rrugën na e treguan kooperativistët me zelin e tyre në punë, tha. Edhe shkollën të mos e ndërpres, edhe bujkeshë e mirë të bëhem.

Ajo është e gjëzuar se ka dhënë provimet që i përkasin gjysmës së vitit të tretë të gjimnazit. Ja modeli i njeriut që përparon, në dallgët e jetës sonë revolucionare.

— Po të mos e vazhdoja shkollën, unë e dëmtotoja partinë. Ja sepse: kur dolla vullnetare për në malësi tregon vajza, pati shoqe që më thanë: ç'të duhet ty aksioni! Ti je në shkollë, në vitin e tretë gjimnaz! Do ta humbasësh shkollën!» Unë, kur erdhë këtu, kujtova përsëri këto fjalë të liga e mendova: në qoftëse nuk do të vazhdoj shkollën, ata djem e vajza që janë në shkolla, do të thonë se aksioni e pengon shkollën. Dhe do të pengohet kështu thellimi i procesit të revolucionarizimit të rinisë, për të cilin ka kaq kujdes partia. Unë me veprimin tim bëra vetëm detyrën që tu tregoj shoqeve e shokëve se aksioni nuk e pengon shkollën. Shkolla kudo i ka të hapura dyert kur di mirë mësimet e partisë.

DASHURIA PËR SHOKUN

1.

Ditët e para të aksionit ne punonim së bashku me brigadën, në sektorin e parë. Vëndi ku do të kalonte traseja ish shumë i thellë dhe e mbushnim duke marrë dhe në kodrën anësore. Po për këtë kishim hapur gropë në fushë.

Kishin kaluar katër ditë dhe tashmë ja kishim marrë dorën punës. Ditën e pestë tekniku kërkoi katër vetë për të hapur kanalin. Aty do të vendoseshin tuba për kalimin e ujrave nga njëra anë, në anën tjeter të trasesë. Viktori, Andoni, Bardhi dhe unë shkuam pas teknikut. Secili me vehte mori nga një lopatë e kazëm.

Do të hapim kanalin, mendoja. Më vinte pak keq se po ndaheshim nga brigada. Vetëm për këtë mërzitesha. Sa për punën jo. Ne për këtë kishim ardhur. Si të punonim atje, në faqe të kodrës, si aty në vendin më të thellë të fushës, ku do të rridhnin ujrat, të njëjtën gjë bënim: ndërtonim hekurudhën: Por ja që, ndërsa çapitesha pas Bardhit, mëndja më rrinte atje, ku valvitej në erë flamuri i brigadës. Tamam sot e gjeti dhe ky, thoja me

vehte pér teknikun, kur isha i vendosur tē çoja aq karroca sa Bujari. Bardhi më mirë tē mos qe caktuar pér këtë punë. Para se tē vinte nē aksion, ai ka qenë i sëmurë. Po ai nuk i trembet kanalit. Po sikur t'i them komandantit pér Bardhin? Jo. Ai do ta kuptoje se dikush ja ka bërë këtë, fshehtas. Do tē ofendohet.

Mendueshëm hidhja hapat.

2.

Kështu ne nisëm dëtyrën e re. Kur punoja me brigadën s'më shkonte mendja kurrë, që atyre tubave tē mëdhenj, tē cilët zbardhnin tutje fusnës disa tē shtrirë e disa me gojë përpjetë, do t'u hapja kanalin. Kurse tani kjo më dukej diçka fare e zakonëshme. Q'është e verteta akoma nē fillim na merrte ndonjeherë malli pér tē, shtyrë një karrocë per te ngjeshur aheun me tokmak, por tē ndrronim punë as qé donim. Si tē thuash, u dashuruam pas kanalit. E quanim: kanali ynë.

Ndodhët shpesh që ne tē katër me lopata e çizme, kalonim permes vendit ku punonte brigada. Shokët na thërrisin: Ej, kanali! Ç'kemi? Ne buzë-qeshnim. Dne si pacashje më ish mbushur mendja që vetëm ne tē katërve na shkonte tē na thërrisje me emrin aqë tē quditshëm pér njerëzit, Kanali. Unë nuk mund t'i mendoja tani ditët e aksionit pa futur nē mes tyre kanalin, kanalin tonë, nē barkun e tē cilit do tē lëviznin ujrat e fushës.

Vetëm një gjë nuk shkonte mirë. Si të them. Ngjante diçka që s'duhej të ndodhët midis shokësh.

Andoni ish më i forti nga ne. Punonte mirë. Ai gjithnjë mbaronte i pari. Por me të mbaruar punë, ikte.

Pranë tij punonte Bardhi, pastaj unë, kurse në skajin tjeter të kanalit Viktori. Andoni pasi kryente vjesën e vet fare mirë, mund ta ndihmonte paksë Bardhin. Ai e dinte mirë, që para se të vinte në aksion Bardhi kish qenë i sëmurë. Pastaj, fundi-fundit shok e kishte. Ja kjo s'më pëlqente. Andoni e kish mëndjen të mbaronte sa më parë dhe të ikte në kamp. Kur ne të tre ktheheshim, e shihnim gjithnjë në këndin sportiv. Më vinte çudi si s'e kuptonte ai një gjë të tillë. S'ishte qëllimi që t'i bënte normën Bardhit. Jo, jo. Bardhi punonte. As ish fiala për t'më lehtësuar mua me Viktorin që e ndihmonim. Këtu cëndronte dicka më e madhe se kryerja e normës: dashuria nër shokun.

Nia dv-tri herë isha matur t'i flisja Andonit. por se si më vinte. Po sikur t'më përgjigjei: Ke hall të shpëtosh vetë ti. Të them të drejtën e kisha marrë inat. Përpinqesha me të gjitha forcat të mbaroja përpëra tij, por s'ja dilja. Dhe kjo vazhdoi gjer atë mbasdite.

4.

Përsëri Andoni kish mbaruar përpëra meje. Ai tani cëndronte ulur buzë viiës së ujit dhe lante cizmet. Pastaj u ngrit, hodhi lopatën në sup dhe trupi i tij u zhduk në shtegun që dredhonte vër në kamp. Tani shikoja vetëm lopatën. Ajo lëku-

ndej sipas ritmit të ecjes. Nuk e di, por ajo lopatë që lëvizte sa andej-këndej në atë qiell të përhimtë, më dukej si të ishte një dorë që më përqueshte... Pastaj edhe ajo u zhduk. Në sfond mbeti kodra e mbuluar me kaçube, në njérën faqe të së cilës punonte brigada jonë.

Unë kërceva jashtë kanalit.

Dielli tani hidhte pjerrtas në fushë rrrezet e tij të fundit, të kuqe e të vakta. Buzë lumit plepat shushurinin.

Fshiva fytyrën me këmishë dhe i fola Bardhit:
— Shtyu pak më tutje.

Ai lëvizi ngadalë çizmet nëpër baltë dhe unë me kujdes zbrita në kanal.

— Po të rrish pa lëvizur ftohesh, iu përgjegja pas pak dhe futa lopatën në baltë.

Ujët, që depërtton mes poreve të tokës, na prish punë, mendoja i kërrusur. Tani dëgjohej vetëm përplasja e llucës, që ne hidhnik jashtë kanalit.

— Viktor! Më jep pak pagurin. Viktori nguli lopatën dhe mori pagurin e gjelbërt.

— Prite!

Vetëm ujët na pengon, vijonin mendimet e mijë, ndërsa mbyllja kapakun e pagurit. Filtron pa pu-shim. Të ish toka argjilore s'do të ndodhë kështu. Por atëherë balta do të ngjitej si rodhe pas lopatës. Sidoqoftë, të bëhet njëherë ky kanal. Është kryesori. Kanalet e tjerë të këtij sektori do të hapen më kollaj. I mbledh ky ujrat pastaj, ky.

Bllaf! Pas kurrizit tim ra diçka në ujë. Ndjeva t'më stërpiken shpina, krahët, qafa. Ktheva kryet. Edhe kjo na duhej. Prita që i kishim zënë ujit në hyrje të kanalit ish çarë. Ai tani derdhej në vendin e punës.

— Hyp shpejt sipër! më thirri Bardhi.

Unë kërceva nga kanali dhe vrapova atje ku hynte ujët. Viktori rrëmbeu kovat dhe u turr nga Bardhi.

— Ta marrë djalli! E gjeti dhe ky. Por prap, mirë që ndodhi tani e jo natën.

Shtyja dheun për të zënë çarjen. Më kot. Rryma ish e fortë. Eh! Të dukej se për ditë me radhë brënda atyre ujrave të palëvizëshme ishte grumbulluar një inat, që tani çfrynte. Do t'na prishë betonin, thoja duke vështruar shkarazi në skajin tjetër të kanalit.

Vazhdoja të hidhja dhe me lopatë, por e çara trekëndëshe e gëlltiste e pangopur. Ky dhe i quillur nga shiu i mbrëmëshëm as që mund ta zërë, bluaja me vehte. Në kanal Bardhi dhe Viktori jepnin e mirrin. Ah, t'ishte dhe Andoni. Viktori vetëm s'ja dilte me kovat.

— Të kishim një dërrasë për ta zënë, tha Bardhi. Shiko, m'u drejtua, se mos ka ndonjë aty rrotull.

Hodha një vështrim përqark. Ja ku qenka një, mendova, por larg. Sa të shkoj deri atje ujët patjetër do të kapërcejë pritën e vogël që ka bërë Bardhi. Betoni i porsahedhur do të shkojë dëm.

— Hë? më pyeti Bardhi.

— Ka një, por është larg.

— Vrapo!

— Eshtë larg. Ujët do të prishë betonin.

— Vrapo po të them!

Bardhi hodhi një hap përpëra, u rrotullua dhe... i vuri shpinën pritës së çarë.

Unë për një çast mbeta i hutuar. Pastaj u lëshova me vrap. Ndër ato hapa që hidhja me çizmet

e rënduara nga balta s'mendoja asgjë, asgjë. Më dukej sikur nga të gjitha anët zëra të pa përcak-tueshmë më thërrisnin: shpejt, shpejt, shpejt.

Kur po kthehesha me dërrasën në sup më doli para Viktori. Kështu të dy, duke rrëshqitur, vra-puam drejt kanalit. Dërrasa u vendos.

— Të largohem? pyeti Bardhi.

— Po, ju përgjegj Viktori.

— Më jep dorën, i thashë dhe Bardhi kërceu jashtë kanalit.

Ndërkohë mbriti tekniku. As që e vumë re se nga erdhi.

— Ç'ka ndodhur? Shpërtheu uji? Po betoni?

— S'ka gjë, s'ka gjë, — iu përgjegj qetë Bardhi.

— Mos... Po ti si je bërë kështu? qull fare.

— Ndrrohem në kamp. Viktor: hidhi dhe ca dhe. Ja tek ajo qoshja e dërrasës.

— Bardhi, hiqi rrobët. Ja tek ke këmishën time, i fola.

— Ndrrohu djalë shpejt, se do të ftoshesh, i tha tekniku. Pra qënka çarë. Kush punon në këtë vend?

Asnjeri nga ne s'i foli.

— Ai, vazhdoi tekniku duke u përkultur nga kanali, që të gërmonte sa më shumë dhe sa më shpeit. ka holluar pritën. Kush punon këtu?

Përsëri asnje s'ju përgjegj.

Ah Andon. Andon, mendoja i zemëruar duke shikuar Bardhin.

— Nejse, foli prapë tekniku. Herë tjetër duhet më kujdes. Shiko! Akoma s'i ke hequr këto ti?

Bardhi hoqi këmishën dhe kanatjerën të qu-llura e tërë baltë.

— Na Bardhi, i thashë duke i zgjatur këmi-shën time. Vishe shpejt.

— Mbaje, mbaje. S'kam të ftohtë.

— Merr dhe trikon time. Ja, është tek ai guri, i foli Viktori, ndërsa me çizme ngjishte dheun.

— Duhet hequr ujët, tha Bardhi pasi u vesh.

— S'ka gjë, ja preu tekniku. Për sonte mjaft. Tani djema nisuni për në kamp.

— Si u qull kështu, më pyeti kur Bardhi me Viktorin ishin përpai.

— I vuri shpinën ujit.

— Me të vërtetë! Xhanan djalë!

— Ty të qënkan mbushur me ujë çizmet, dë-gjova Viktorin t'i thoshte Bardhit, kur ju afrova.

5.

Në çadër gjetëm vetëm Andonin, ishte shtrirë dhe pushonte. Asnjëri nga ne s'i foli. Seicili mori peshqirin dhe sapunin.

— Ç'u vonuat kaq sonte. Po ti ç'qënke bërë kështu, iu kthyte Andoni, Bardhit. Mos kape ndonjë lepur?

Buzëqeshi. Por ajo i ngriu në fytyrë. Për një çast ai m'u duk si i ngërdheshur.

Askush s'iup përgjegj. Përsëri për një moment çdo gjë sikur mbeti pezull aty brënda cadrës sonë.

Pas darkës pashë Viktorin që po i fliste Andonit. Kur erdhi pranë meje më foli:

— Ja thashë. Po, po, ja thashë të gjitha. Të paktën ta ketë të qartë.

Atë natë ramë më shpejt se herët e tjera. Ishim të lodhur.

Vonë, nëpër gjumë, dëgjova një të kollitur. Pastaj një të dytë. Më doli gjumi. Ç'do të jetë? Përsëri një e kollitur. Hapa sytë. Drita e hënës hynte nëpër të çarën e hollë të derës së çadrës dhe si një rrÿp i ndritshëm pasqyre, shtrihej mbi trupat tanë.

Ai që flinte pranë meje u kollit.

Oh, Bardhi, menjëherë mendova. Është ftohur. Duhet t'i hedh bëtanien time. Dhe bëra të ngrihem. Por u ndala. Një hije lëvizi nga skaji i kundërt i çadrës. Ajo iu afrua Bardhit dhe ... i hodhi një batanie përsipër. Për një çast drita qumështore e hënës ra mbi fytyrën e hijes. Ishte Andoni.

UDHË VULLNETARËSH...

Nuk besoj së ka në vendin tonë një rrugë më të zhdërvjelltë, me aq shumë brryle e leqe sa ajo e Leqeve të Hotit dhe as krahinë me një bukuri të ashpër e me një terren kaq të shkapërdredhur sa viset e Kelmendit. Kur themi se ne i jemi futur revolucionit në thellësi, kjo do të thotë edhe që ne e futim atë në zonat më të thella malore. Dhe kur sheh që këtu pulsi i jetës rreh mu në mes të shkrepave, kupton se me ç'gjëmim rreh zemra e atdheut.

Një vit më parë, qindra studentë, me një shall aksioni në qafë, erdhën dhe ecën këtej rrugë pa rrugë. Orë të tëra më këmbë. Dikush edhe u tremb para vështirësive. S'kishte ecur kurrë kaq shumë. Dikë e zuri gjumi në mes të gurëve dhe mezi e gjetën. Komandanti, një oficer nga Skrapari, ndonëse kish bërë po atë rrugë, zbriste nga Selca natën dhe merrete në krahë ndonjë vullnetar të këputur nga udha e gjatë. Atë natë vullnetari i fundit mund të ketë mbritur aty nga ora 10 e natës. Ky ishte fillimi. Por ja që këto duar të rinjsh zunë kallo, thyen shkëmbinj, hapën rrugë. Kaluan muaj dhe maqina e Sali Shehut me targën

17-78 shkeli e para nëpër Leqet e Hotit. Dhe buria binte e binte. Thonë se atë ditë fëmijët, malësorët, kishin ndjerë një gjësim të jashtëzakonshëm. Të tje- ra burije gjëmuani nëpër shkrepë e lugje. Mbartnin ato çimento 500-she për ndërtimin e urave të reja, mbartnin tulla, tela e izolatorë të bardhë për centralet e reja, për shtyllat rrëzë katarakteve, bri kullave me çati të lartë ahu. Por si erdhën ato, si lindën kaq pa pritur në këtë pejzazh të çuditëshëm? Ishte një përpjekje prej viganësh që i bëri të shkunden këto pejzazhe vigane të kohëve.

U ngritën atëhere një trumbë çadrash në Grabom. Një tjetër në Tamarë e një e tretë në Selcë. Dy të parat tani s'janë më. Ato ecën drejt Vermoshit. Shtegëtuani. Nga larg këto trumba çadrash dukeshin si trumbë pullumbash. Dhe pullumbat fluturuan drejt veriut. Kjo stafetë malore origjinale, kjo rendje e qytezave, do të vazhdojë kësaj ane deri aty nga 16 tetori 1968.

Nga kabinetat dhe spondet e maqinave, udhëtarëve, veç kurorës me shkrepë e katarakte, do t'u duket sikur çfletojnë një album të gjallë të një piktori të papërsëritshëm. Pejzazhet e Cemit të mahnitin. Maqina jonë kalon tani mbi urën e Tamarës. Është një urë me harqe e me shpinë të kalldrëmtë. Të tilla gjen edhe në jugë. të ndërtuara që nga koha e Ali Pashës. Një malësor me kokën lidhur me shami, që ka zbritur në qytet për të térhequr disa pajisje për një çerdhe të re, na trengon legjendën e kësaj ure. Dikur, një njeri deshi një vajzë me emrin Tamarë. Ditën e dasmës ajo nuk mund të kalonte në lumë si krushqit. Kelmençasi atëhere vendosi të ngrinte një urë. Dhe e quajtën ura e Tamarës. Mbi këtë «kockë të fortë»,

si një legjendë e re mbi të vjetrën, do të ngrihet një tjetër urë... Mbi këtë urë rrrotat zgjojnë në kaldrëme tingujt e legjendës së lashtë. Mbi këtë ecën sivjet 1400 vullnetarë të rinj. Ata nuk ndertojnë më një urë dhe nuk shkruajnë më një legjendë. Ata ngrenë dhjetra ura dhe çelin 75 km. rrugë automobilistike. Ata shkruajnë një roman heroik, që mund të titullohet edhe kështu: «Rinia e zjarrtë e aksioneve».

Gjatë dimrit, mbi male, mbi lugje, mbi rrugën e lënë për gjysmë, ra dëborë. Erdhi pranvera dhe vullnetarë e të rinj nga vise të ndryshme u mblo-dhën përsëri në Selcë. Përsëri filloi një këngë kaz-mash, barominash e varesh. Si kulme të saj herë pas here ngrihen shpërthime minash që shpartal-lojnë shkëmbinj e që i çelin udhën udhës. Kjo rrugë do përpjekje, heroizëm. Dhe këtu ai nuk pikon, por buron.

I ngjitemi këmbadoras një shkëmbi të pjerrët ku punojnë të rintjtë e të rejat e fshatravë dhe të qytetit të Tiranës.

— Na thonë brigada «Myrteza Kepi», — sqaron një djalë nga Selita. Futemi mes pluhurit të barominave dhe motopistoletave. Jemi tek ata që kanë «hesape me shkëmbin», — siç thotë një i ri. Është kaq lart sa vetëm duke parë poshtë të merrën mentë e mund të biesh. Të thuash «punë e mbarë» këtu është shumë pak. Të rinj varur me litarë hapin gropë për t'i mbushur me dinamit.

— E rrezikëshme? — pyes njerin. — Si qëndron ashtu?

— Vend e pë vend. Mezi të zë këmba një «sqep» guri, — thotë ai.

Këtu tani punojnë 10 nga të 40 «shokët e shkëmbit». Dhe ata i drejton Haxhiu.

— Tek ne kuadrot punojnë jo me një të tretën, por me dyfishin e kohës së punës. Me një fjale, s'ka burokraci. E qartë? — thotë një i ri dhe përsëri ngre varenë.

Përposh janë dy shtëpi kelmendase. Kur malësori del herët në agim nga dera e kullës së tij dhe sheh se lart, si një tufë shqiponjash, të rintjtë i bëjnë një sharrim të pazakontë shkëmbit, ai nuk mund të mos mendojë për këta trima të rinj.

— He, m'u lumtë, o sokola të partisë! — na tha ai malësori që e ka shtëpinë në krye, — thotë Haxhiu. — Këtu ne jemi në kufi. Veç për këtë do ta hamë me dhëmbë shkëmbin. Kështu. Dhe pikë.

Haxhiu është shofer i degës së farërave në Tiranë. Në shumë rrethe ka çuar farë ai.

— Vetëm këtej jo. Pa, pa, ç'vend! Kur suallëm rrugën këtu e po s'do të mbetet gjë pa u bërë, përnder, po!

— Kur të kalosh këtyre fshatrave, veçanërisht tek ky shkëmb, patjetër do ta mbash maqinën, do t'i biesh fort burisë dhe do të kujtosh kohën e aksionit.

— Si or jo? Pse, harrohet dita e parë, kur u lidhëm me litar? Tani kemi bërë alamet shkalle, por në fillim ishte ná... — thotë ai duke anuar pëllëmbën e dorës.

Ndodhi kështu: Në mbledhjen e sektorit u shtrua:

— Kush do të dalë vullnetar tek shkëmbi?

60 vetë u regjistruan njëri pas tjetrit. U zgjodhën më të fortit. Dhe ja, të nesërmen ata u gjen-

dën majë shkëmbit, si mbi një podium vigan. Li-dhën litarët në një shkozë e në një frashër.

— Prit, Haxhi, të shohim shkëmbin! — tha komisari.

— Shkëmbin e pamë. Tani le të na shohë ai ne! — u hodh Haxhiu.

— Do të zgres unë, — tha komisari.

— Jo, — tha Haxhiu. — Prit një herë.

U lidhën që të dy. Pastaj ata u zhdukën.

— E ore! — u thërrisin shokët. Në vend të «mirë, or mirë» — dëgjonin tingullin e varesë mbi barominë. U çelen vrimat e para. Plasën minat dhe të nesërmen zbritën dhjetë të tjerë.

Klasa punëtore tek ne éshtë boshti i shoqërisë. Edhe kur flet për fshatin, edhe kur flet për këta vullnetarë, nuk mund të mos flasësh për klasën punëtore, për frymën e saj që depërton kudo. Heroizmi i saj éshtë më i ndërgjegjshmi. Guximi i saj éshtë më i bukurji. Ja sepse shokët e duan Haxhiun.

— Sot ma mblohdhi masa, — thotë ai. — Më urdhëruan të mos futem më poshtë. Fryn shumë erë. Keq e kemi vetëm me sytë. Le, po më ka ndezur dhe me komisarin.

— Eja më kontrollo, — i them.

— Jo, jo. Ti je punëtor dhe klasa punëtore ushtron kontroll mbi këdo, — thotë ai».

Dhe çdo ditë atë e kapin vullnetarë të rinj: «Haxhi, merrmë edhe mua tek shkëmbi. Do të punoj mirë» — i thonë.

Kur të kalojnë udhëtarët tek ky vend me emrin e bukur «Shkambi i Rrethit të Bardhë», le të kujtojnë se këtu ka punuar edhe një shofer. Atë do ta gjejnë rrugëve të atdheut kur i bie burisë së Gazit me targën. 19-92.

— Kur erdhëm në fillim, ende s'kishte shkrirë bora, — thotë një e re. — Ai shpati përtej ishte plot. Tani ka mbetur vetëm një rrip i vogël. Të tillë ka në çdo faqe mali. Sa bukur që duken! Sot kemi çfaqje. Ejani ta shihni!

— Ç'thotë «Traktori» i Lushnjës? — pyet dikush.

— Po i kthen malet në fusha, — përgjigjen.

Malësorët në Myzeqe shtrojnë shina të hekurta. Myzeqarët në Kelmend çelin rrugë. Ndrrim postesh dhe fronti bëhet më i fuqishëm.

Durrsakët punojnë pranë një katarakti. Vullnetarëve të vtitit të kaluar u kujtohet se si zbriste ai nga lart si një litar i bardhë. Si një litar që çthurej kur frynte veriu i majëmaleve. Por katarakti tani ndryshoi shtrat, devijoi. Zbret njëherë mbi rrugë e pastaj derdhet me më pak vrull. Rënia e tij natyrore është fiksuar vetëm në fotografitë studenteske.

Brigada «Adem Reka» mban për të tretën herë flamurin e sektorit. Këto vajza të shkathëta e të gjëzuara, këta djem punëtorë që çdo muzg e çdo agim e mbushin me këngë, dinë të çelin rrugë e të ndërtojnë jetë...

— Grupi i elektrifikimit, pasdite do të shkojë nëpër shtëpitë malësore! — thotë komandanti.

Nga megafoni, mbështetur mbi një bigë arre, përhapen tingujt e një kënge gazmore. Në këta shkrepë ajo bëhet shumë e dashur dhe merr një timbër të veçantë. Çdo pasdite zhvillohet konkursi. Këngë, valle, parodi, skeçe, që lindin aty për aty. Punohen materiale të partisë e të shokut Enver. Jeta kalon mbushur me ngjarje dhe emocione të reja.

Vajzat e Buzmadhit në Fier, kur të kthehen në fshat, do të çojnë këtë ambient aksioni. Ato janë rreth 30. Këtu kanë krijuar grupin artistik.

— Po, kur të kthehem i nё fshat, ndonjeri do të thotë:

— More, po paska ardhur estrada e shtetit këtu! Shikoni ç'bëka aksioni!

— Shoqet tona që shkuan në hekurudhë, u shoqëruan edhe me ndonjë prind. Ne jo. Dhe kjo është gjë shumë e madhe.

Mbi çadrat vullnetare po bie muzgu. Muzgjet aq të bukura të atyre viseve të zgjojnë kujtime. Këto çadra janë ngjitur me shtëpinë e Norës së Kelmendit. Vecse nё to s'jeton osmanlliu, të cilin Nora e vrau me thikë nё dorë brënda mu nё çadër. Nё to jetojnë Norat e reja, Norat e 1968-ës...

ZËVËNDËSIMI

I biri kish rënë në përpjekje me armikun. Kur erdhi i ati, ne i thamë:

— Djali nuk ndodhet tani. E kemi roje.

— E dij, tha ai — kam prurë djalin tjetër për ta zëvëndësuar në roje partizane.

Kjo bisedë nuk ka të bëjë me ngjarjet e këtij tregimi. (Ajo thotë se kur u vra një partizan, gjatë luftës, i vëllai erdhi dhe e zëvëndësoi). Po kjo përkon me ngjarjet e ditëve të sotëshme të punës, përkon me Shkurten: historia e ngjarjeve të ditëve tonë rritet si një vazhdë e luftës. Unë nuk do të tregoj për Shkurten, por për një rast tjetër, ku heronjtë e ngjarjeve jetojnë dhe sot. Ata i gjeta në udhë të hekurt.

Ishte...

1

Kjo ndodhi në vitin 1967, më 2 maj. Atëherë sa ishte formuar kooperativa malore. U shtinë pushkë për këtë: zakonisht pushkë shtinin kur familjes i lindëte djale (simbas mendimit «shtyllë e

shtëpisë») dhe kur bëhej dasmë, se këto ishin kthesat familjare. Po jeta jonë mbrujti dhe një kthesë të re: pushkë për formimin e kooperativës . . .

Si anëtar i kësaj kooperative ishte dhe një i ri. Ai quhej Hysni. Kish vetëm babën dhe nënën.

Më 2 maj ai dhe Mali, një shok i vet, ngarkuan mushkat me patate për t'i çuar në kooperativën fqinjë, se i duheshin për t'i mbjellë. Mushkat djersitnin nga barra.

Kooperativa fqinjë priste patatet. Rruga është e gjatë, e lodhëshme.

— Mali, një kapsulë mine.

— Ku e gjete?

— Ja . . .

Hysniu diç po gërmonte në atë kapsulë mine.

— Kujdes, ato janë të rrezikëshme!

— T'i lajmërojmë me krismë se po sjellim patatet për t'i mbjellë.

Livadhet, kështu quhej vendi, heshtnin dhe kishin freski asaj dite maji. Po Hysniua prishi qetësinë.

Një krismë.

— Hysni!

U duk sikur krisma për të dhënë lajmin, shpërtheu nga grushti i tij: gishtat e dorës së majtë u copëtuan.

Kështu mbaroi pjesa e parë e këtij tregimi.

Aksidenti ndodhi. Mali e kapi për krahu Hysniun dhe ktheu rrugën.

— Ku po më shpie?

— Në spital.

— Po patatet? Ata presin të mbjellin.

— Le të presin.

Hysniu e mblodhi veten nga kjo krismë.

— Jo, do të çojmë më parë paçatet.

— Ti s'je në vete, or burrë!

Ku ishte burrë ai (!) Ai ishte nëntëmbëdhjetë vjeç.

— Ata presin. Folu mushkave, Mali!

— Po ti, nuk ke marrë? . . .

— Mali, po ti po vonon. Unë e kuptoj sa më tepër të vonohemi, aq më keq për mue.

— Hajde, pra.

— Unë po kthehem vetë në spital. Ik e ço patatet.

Një vazhdon rrugën për në kooperativën fqnjë ku e presin për patatet, një kthen dhe vepron tërthoreve.

Monopatet panë një nëntëmbëdhjetë vjeçar me njërin grusht të coptuar. Ai ish i vetëm po veten nuk e lëshoi: shoku ish nisur të kryejë detyrën.

Hysniu arriti në spital.

— C'ka ndodhur? — i thanë atij.

— Kishim ngarkue patate . . .

3

Pjesa e tretë e këtij tregimi fillon më 15 mars 1968.

Në spital Hysniut i kishin hequr tre gishtarinj, ndërsa njërin ai nuk e lëvizte dot. Dhe sot e kësaj dite ai ende ndjen dhimbje në dorën e majtë e kjo

ndodh nga që nuk është rrahur me punën, se koha e aksidentit nuk është e largët.

Dhe vazhdoi të përshkonte ai tërthoret e maleve, mbas kafshëve të ngarkuara.

Ishte i ri, 19 vjeç. Shihte shokët që punonin më shumë. Dora i dhëmbte.

Një natë ai shkoi në shtëpi gas e shënd.

— Ç'farë ke? — e pyeti baba.

— Dola vullnetar.

Nëna i tha:

— Druhem se nuk kanë me të pranue.

Po ai shkoi vullnetar.

— Udhë të mbarë! — e uruan prindët djalin e vetëm.

Kështu ështëjeta jonë: fëmijët veten, çdo gjë ia kushtojnë Atdheut. Unë, nuk e dij, pse e shëmbellëj këtë çast me nënën e Llesh Palit, kur nisi të birin ushtar. Kur e takova një herë, para disa vjetësh, ajo më tha: «E përcollë nana ushtar». Po kënga thotë: «E martoi në vijë të kufinit». Dhe ai 19 vjeç ishte.

4

Prindët përcuallën Hysnium vullnetar.

Ai ndeji në hekurudhë vetëm 15 ditë. Punonte së bashku me shokët. Ato ditët e fundit se si u hap fjala në brigadë që dora kish mundësi t'i rregullohej. Sa do ta dëshironte ai një gjë të tillë! Ai s'e kish dorën ndaj dhe e çmonte atë si vlerën më të madhe. Ajo vazhdonte t'i dhimbte gjatë punës.

Një ditë ai shkoi te mjeku.

— Për çfarë ankohesh? — e pyeti mjeku.

— Due me më rregullue dorën! Më kanë thë-në se rregullohet.

— Kush?

— Shokët e mij, po ajo më dhemb ende e më pengon.

Mjeku si e vizitoi tha:

— Ti nuk duhet të punosh. Duhet të ktheheshtë shtëpi.

— Jo, he burrë! A don me luejt me mue?

5

Dhe një ditë ai u gjend në shtëpi. Kur e pafat ati, tha:

— Po ti, ku i ke shokët?

— Në hekurudhë. Unë nuk mujsha me punuedot.

— Sa të muishe, veç të kishe ndejt me ta.

— Më përzuni doktori.

I ati ndejeti një çast si i zënë ngushtë. Ata ishin përballë njëri tjetrit: dy mosha, dy jetë, një mendim.

— S'ka me ndejt kazma bosh, — tha baba.

— Më thanë shokët, se do të punojnë dhe përmue — tha djali.

6

Idrizi tani është në hekurudhë. Atë nuk e thërrasin në emër, po thonë «Babai i Hysniut». Ne tani bisedojmë qetë qetë në një qoshe të barakave. Unë mundohem të zbuloj shkaqet që e shtyjtën

atë të zëvëndësojë të birin. Po Idrizi shpjegon thjeshtë:

I thashë sekretarit të partisë: «A po më ep një shkresë se due me shkue në hekurudhë në vend të djalit?»

— Pse, ku asht Hysnia?

— E ka kthyesh doktori.

Dhe ai ia dha shkresën. Idrizi erdhi në hekurudhë, vullnetar.

— Faleminderës prej brigadës, më ka pritun mirë!

Kështu ai zëvëndësoi të birin. Më gjatë nuk shpjegon. Dhe është e kotë të mundohesh për të zbuluar nga biseda atë diçka që e shtyjti të ndërma-rrë një veprim të këtillë, se ky zëvëndësim është i ligjshëm, është diçka e qënësishme që përbën jetën tonë: asnje vend nuk mund të ngelet bosh, Atdheu na fton.

Ja kështu historia e ngjarjeve të ditëve tona rritet si një vazhdë e luftës. Një vritej në luftë, atë e zëvëndësonin të tjerët, Shkurta ra, atë e zëvëndësoi gjithë një rini...

Dhe Hysniu nuk mundej, nuk e lejonte mje-ku, po i ati kapi kazmën e tij.

NAFTËTARI DHE NAFTA

Jeta e tij është e lidhur fort me naftën. Puna e mirë e ka bërë të njojur në kolektiv dhe çdo punëtor thekson me krenari se «ai është naftëtar». Këtij naftëtar i përket dhe kjo që tregojnë:

... Pasi mbylli, me përpjekjet e përbashkëta të të gjithë shokëve, fontanën e pusit B-35, Nebiu i larë krejt në naftë, drejtohet për në shtëpi.

— S'e harrove shtëpinë e vjetër, — i thotë një shok në të hyrë të lagjes.

Nebiu buzëqeshi. Nuk e kuptoi ç'deshi t'i thosh shoku me atë «shtëpinë e vjetër».

— Si duke shku me shtëpinë e re? — vijoi pyetja.

Tani naftëtar i kuptoi se adresa e shtëpisë së tij ishte ndërruar. Kolektivi i kishte dhënë shtëpi të re. Shokët ishin kujdesuar, kishin ndihmuar familjen në sistemimin e plaçkave. Naftëtar i ndrroi rrugën, u kthyte nga shtëpia, që ende nuk e dinte pikërisht ku binte. Zemra i dridhej nga gjëzimi. Mendonte: «nafta kalit shoqëri të fortë...»

Puna e naftëtarit është një mjeshtëri e hollë, lum ai që e zoteron! Nebiu qëndron para nesh si naftëtar. Por kjo do të thotë të jesh edhe meka-

nik. Dhe Nebiu është mekanik. Kjo do të thotë të jesh edhe montator. Dhe Nebiu është edhe montator, bile i rrallë. Kjo do të thotë të jesh traktorist. Dhe ai është dhe traktorist. Shkurt, ai ka një mjeshtëri që përfshin shumë mjeshtëri. Dhe që t'i zotërosh ato mjeshtëri që i duhen naftës, duhet të jesh naftëtar i vërtetë.

— Nafta i duhet Atdheut. Ne e duam Shqipërinë, duam ta bëjmë të fortë, të fuqishme e më të fuqishme. Prandaj vendosëm që këtë vit të kemi një rritje të hovëshme në prodhimin e naftës.

Kështu na tha Nebiu. Ky është mendimi dhe vepra e kolektivit të NMSH-së së prodhimit të naftës Nr.1 në Patos. Dhe ai i hyri kësaj pune dhe do t'ja dalë, ai i ka parasysh të gjitha përpjekjet titanike që duhen bërë për të rritur prodhimin e naftës. Duhet punë e lodhëshme pér të marrë sa më shumë naftë nga puset që janë në veprim, duhen shtuar puset e reja. Dhe bashkë me këto duhen marrë masa të jashtëzakonëshme organizative në prodhim, duhen bërë investime të reja në zonat e puse. Të gjitha me forcat dhe rezervat e brendëshme. Në këtë front pune të lavdishëm po rriten naftëtarë të lavdishëm.

Edhe Nebiu u rrit bashkë me naftën. Jeta e tij ka po aq histori sa nafta.

— Kur fillova punën këtu, më kujtohet si tanë që një inxhinier u shpjegonte punëtorëve këtë që po bëjmë sot, — thotë ai.

Aty afër ishte pusi. Punëtorët po nxirrin tu bat nga thellësia, pasi pusi kish nevojë pér riparim nëntokësor. Tani naftëtarë e di se ç'duhet bërrë. Atëherë nuk dinte. Por Partia i kishte thënë se do të bëhet naftëtar duke punuar e studjuar.

Të ndrrosh një pompë atje thellë nën tokë, është punë e vështirë. Bile këtë punë ai e mësoi dhe bëri sa e sa ndrrime pomdash në puse jo vetëm në shtresat e njobura, por edhe në shtresat e reja. Vullneti i fortë, puna këmbëngulëse e ngriti punëtorin e thjeshtë në cilësinë e mjeshtrit. Ku ishte puna më e ngutëshme dhe më e vështirë për riparimet nëntokësore të puseve, thirrej brigada që drejtohej nga Nebiu. Shpesh ndodhë që ai të qëndronte në krye të punës me ditë të tëra, pa pushuar. Vinte përgjegjësi i zemëruar:

— Nebi, sa herë më duhet ta përsëris? Ju akoma nuk bindeni të lini punën? Shko, i dashur: pas punës punëtori ka nevojë për pushim.

Naftëtar i bindej përgjegjësit, disiplinës. Me hapa të vegjël, kokën ulur, krejt i pakënaqur, largohet. Por nuk arrinte dot gjer në shtëpi dhe kthehet përsëri në punë. Përgjegjësi përsëri e «zbulonte» dhe e «dëbonë». Po kurrë nuk ja dolli: Nebiu kthehet në shtëpi vetëm atëherë kur nafta rridhete nga pusi, mbushte depozitën, shtyhet me pompa nëpër tubacione drejt uzinave të përpunimit.

Gëzimi më i madh për një naftëtar është zbulimi i zonave të reja naftëmbajtëse. Nebiu nuk mund ta harrojë kurrë atë kohë kur pompa nga thellësia e pusit V-622 nxorri curilet e parë të naftës.

— Pusi qe shumë i gjallë, — i rikuiston Nebiu.
— Ai jepte mjaft erupsion. Kështu e ka nafta, del e pakomanduar...

Ditë e netë pa gjumë, punë plot mundime e lodhje. Por asnje naftëtar nuk tha «u lodha», pasi ndiente gëzim e forcë sa ç'ndjente Atdheu. Dhe nafta u komandua nga naftëtarët tanë. Tani pusi V-622 është rrethuar nga një pyll i tërë kullash

metalike. Nafta rrjedh nëpër tubacione. Sot këtu është zona e re e naftës, e komanduar nga mjeshtër të zotë.

Po Nebiu? Edhe ai rritet, përsoset në mjeshtëri. Shton punën, studimin, këmbënguljen.

Në një pus nafte dolli kjo çështje: Giatë punës që bëhej për përvetësimin e tij, presioni u rrit në grykën e pusit. U rrit 107 atmosferë. Kurse pajisjet ishin të presionit të ulët. Duheshin vendosur pajisje të presionit të lartë.

— Vete unë t'i ndrroj pajisjet e grykës, — tha Nebiu.

Në momentin kur po bëhesh montimi përfundimtar, pusi shpërthen fontane gazi. Dolli një rrezik serioz: mund të shpërthente flaka.

Duhej një konsultim për të kapërcyer këtë vështirësi serioze, të papritur.

— O burra, të zëmë pusin! — gjëmoi zëri i Nebiut.

Shokët e panë atë që u hodh në grykën e tij. Dy orë rrjesht i bëri ballë ai fontanës së gazit. Por thonë se gazi s'di shaka: të ze frymën. Nebiu ra i tronditur nga era mbytëse. Drejtori nxitoi t'i hiqte vërejtje mjeshtrit, i cili ishte shumë i shaftësuar për shokun. Kur një ndodhi tietër e përbysni ngjarjen. Nebiu u ngrit. U vërsul përsëri në grykën e pusit që villte gaz fontane. Punën që la përgjysmë e vazhdoi deri në fund.

Pusi u zu. Naftëtarët përqafohen. Mieshtri nuk harron t'i japë përsëri këshilla. Por ja, disa ditë më vonë para naftëtarëve u çfaq përsëri një pus i ri kapriçioz.

Atëherë holluesi nuk përdorej me automate që të rregullonin dhënen e holluesit në puset në shfry-

tëzim. Duke mos përdorur automatet, krijuarët e shumë Nebiun me shokë, pasi puset ndalonin shpesh. Prandaj i hynë punës për vendosjen e automatëve. «Nebiu përbalon cdo punë. Atë ne e njohim si njeriun e gatshëm e të aftë dhe kemi një besim të përba-shkët. Ai është mjeshtër i rrallë i pastrimit të pu-seve të naftës» — tha një naftëtar.

Disa kohë më parë Nebiu i tha sekretarit të organizatës-bazë se komunistët duhet të zoterojnë e të drejtojnë mirë edhe maqineritë e rënda. Vullneti e studimi bëjnë cdo gjë. Brënda një kohe të shkurtër Nebiu mësoi të drejtojë traktorin e rëndë që përdoret për pastrimin e puseve. Fronti i tij i punës nuk është një pus nafte, por gjithë fondi i ndërmarrjes.

Një ndodhi e re në pusin B-35 e ngriti akoma më lart ndërgjegjen e punës së këtij punëtori. Pusi shpërtheu fontane. Dymbëdhjetë ditë e dymbëdhjetë netë Nebiu s'iu nda grykës së pusit. Akoma edhe sot fusha nxin nga veprimi i fontanës, që kish një rreze prej më se 20 metrash. Kur shpërtheu kjo fontanë, arriti urgjent në vend reparti avaroshpëtues i minierave. Nebiu mund të thoshte edhe kështu: «Unë jam traktorist. Punë këtu s'kam. S'jam as anëtar i repartit avaroshpëtues». Dhe mund të hiqej mënjanë. Por ai nuk ka ndërgjegje mikroborgjezi, por ndërgjegje të shëndoshë të klassës punëtore. Ngarkoi bombolat me oksigen, veshi maskën dhe u drejtua te gryka e pusit. Kolektivi ishte shumë i shqetësuar për fontanën, por edhe përdicë shumë më serioze: mos rrëmbehen nga puna

shokët dhe harrojnë kujdesin për jetën? Ja thanë këtë Nebiut dhe e këshilluan të largohet. «S'është punë për ty», e këshilluan. Dhe vërtet të hapje e të mbyllje saraçineska në grykë të këtij pusi duhej vënë përpara edhe jeta.

— Pusin do ta zemë patjetër, — u jepte zemër shokëve Nebiu.

Midis gazit e naftës që shpërthenin me zhurmë shurdhuese nga thellësia, ditë me radhë qëndroi e punoi ky mjeshtër i nafës. Ai pati guximin ta mbylli vetë saraqineskën qëndrore, duke i bërë ballë një presion gazi e nafte prej 100-120 atmosferash.

Pikërisht ky qe ai naftëtar që i solli një gëzim të madh gjithë kolektivit të naftëtarëve të NMSH-së së prodhimeve të naftës Nr. 1 në Patos. Por pikërisht këtë ditë kolektivi, kishte vendosur t'i jepte shtëpi të re.

— Po ta kishim pyetur, ai do të na thoshte: «Unë jam mirë. Jepini shtëpi një shoku tjetër që ka më shumë nevojë», — tregon Reshati, sekretari i komitetit të partisë i ndërmarrjes.

V U L L N E T A R È T

— Makina duhet hequr — tha edhe Aleksi. Ai pa nga dritarja agimin që po skuqeje dhe u dëgjoi këngën vullnetarëve që vazhdonin të mbartnin në krahë listela e tulla.

« — O prina moj Parti e dashur

prina ne... »

— Po, po, makina na duhet. Ja, tani po ta kishim do ta nisnim me gëlqere për në Lladomericë — tha shoku i shtabit me sy të skuqur nga pagjumësia. — Si drequin i ndodhi këto ditë?! — Ashtu është. Veç kësaj s'duhen penguar njerëzit — tha edhe traktoristi. — Unë po nisem që tashti, si thoni ju?

Shoku i shtabit me sy të skuqur, që kish vënë në vesh receptorin, pohoi me kokë.

— Për disa minuta më ke edhe mua pas, — tundi kokën Aleksi.

Në shtab hynin e dilnin, njëri jepte urdhëra, dikush shkruante me nxitim dy fjalë në një copë pusullë, një zile telefoni që bie.

«Stalineci» që ndodhej jashtë shkuli pllakat e zinxhirëve nga dëbora e ngrirë dhe, si u rrotullua në vend, mori kthesën e u nis.

— Të marr ca dërrasa — tha Aleksi — do të na duhen për atje.

— Përse?

— Po ja, t'i vendosim gur mbi gur e i afrohem makinës.

Shoku i shtabit me sy të skuqur i shtrëngoi dorën dhe i uroi:

— Punë të mbarë!

Makinat e ngarkuara me materiale shpejtonin. Asnjë nuk ndodhej bosh. Të gjitha lëviznin e diku shkronin. Ai s'mund të priste më. Pastaj a mund të pengoheshin makinat në këtë kohë?

Dhe s'e vrau gjatë mëndjen. Pellgu i Gradecit ndodhej gjysmë ore larg. Aleksi vajti tek stiva dhe zgjodhi tre dërrasa të gjata. U përkul, i vuri mbi kurriz, po pesha e tyre e kërrusi. Pastaj u çapit mes për mes dëborës.

Puna me turne e vullnetarëve e kish zgjuar që natën.

— Ndofta qe i vetmi shofer që s'i njihte këto gryka, andaj i ndodhi ajo që... — mendoi Aleksi dhe iu kujtua ngjarja.

I ftohti, që dita ditës sa vinte po shtohej, i spërkatë malet me dëborë. Dëbora solli me vehte prej bjeshkëve një erë të ftohtë dhjetori që të mpinte. Pas kthesave zik-zake dukej sikur mbinin makinat. Autokollonat, me materiale për zhdukjen e rrënimive të tërmëtit, lëviznin nëpër Dibër. Nga qelli flokët e butë e të bardhë, herë si miza e herë si flutura, derdheshin gjithënjë dendur e dendur. Makinat me zinxhirë e pa zinxhirë e shtruan dëborën, e shtypën dhe e ngjeshën mirë. U formua një akull i lëmuar si xhami që natën prozhektorët e makinave e bënin të ndriste.

Mbrëmë në një kthesë të fortë një makinë pa zinxhirë rrëshqiti: gomat s'iu bindën frenave dhe ajo filloj të bjerë te poshtë. Shoferi arriti të dalë, ndërsa makina ra në Drin, në pellgun e Gradecit. Kjo ndodhi në rrugën midis Shupenzës e Maqe-llarës, atje ku nga një anë lartohen shkëmbinjtë e në krahun tjetër gumëzhit rrëmbyeshëm Drini.

Shoferi që shpëtoi e që ishte futur në ujë gjë mbi gjunjë për të dalluar makinën, arriti në mesnatë i tkurrur. Me buzët e mavijosura ai pëshpëriti disa fjalë dhe ata të shtabit e kuptuan ngjarjen. Mjeku urdhëroi që të shtrohej urgjent në spital se mund të qe plevitosur. Shoferi që s'dinte ç'të bënte iu bind atij.

Vullnetari, nën peshën e dërrasave, me bisht të syrit vështronte anash natyrën që i çpalosej.

Ai vinte për herë të parë në Dibër. Kish dëgjuar të flitet për madhështinë e ashpërsinë e kësaj krahine. Por Aleksi nuk erdhi për ta parë vendin, ai erdhi për ndihmë. Mikpritjen e dibranëve e njoju që natën e parë. Ata i priten me zemër të hapur si vëllai-vëllanë në atë kthinën e ngushtë e të pashëmbur.

Gjatë këtyre ditëve kish parë e njojur shumë gjëra.

Kaloi pranë stallave të koperativës dhe vërejti dy kazanët e mëdhenj me ujë, që po i ngrohnin për të pregetitur llaçin. Iu kujtua shtëpia që ngri-tën për dy ditë e për dy netë. E, kohë rekord — mendoi. Ata lot në sytë e fëmijëve të nënë Sabries që dolën nga çadra pranë manit e hynë në dhomë. Iu kujtua ajo marangozja laçjane që punonte me turnin e natës e pregetiste dërrasa për dyshemetë. E gjatë kohës që do të qëndrojë këtu kishte ven-

dosur t'i mësojë proçesin e punës në sharrën — kombinat edhe asaj moshatares së saj vëndase. Po ai shkodrani që preu dorën me sharrë dhe nuk e la punën?

— Hej!... shoku vullnetar — dikush i thirri Aleksit dhe ai ndjeu afër një frysëmarrje të rëndë. Pranë i erdhi një njeri. Ai mbante në duar dërrasa. E shikoi nën vetulla dhe... njohu shoferin.

— Po ti more? — e pyeti me zë qortojës.

— Po vij për te makina.

— Të lejoj doktori të dalësh?

— Ohu, doktori të mban për një kollë tri javë.

Sa ju pashë më vajti mëndja se po shkoni atje. I shashë infermieres, por s'qe e mundur. Ashtu. I mora një shoku pallton dhe dola nga dritarja.

Aleksi i pa poshtë palltos së shkurtër pizhamatë me vija të spitalit.

— Unë të them të shkosh menjëherë.

— Jo, jo, në asnje mënyrë!

— Atëherë, ose kthehu ti ose po kthehem unë

— e ngriti zërin Aleksi dhe ndaloi në vend. Shoferi u fut përmes déborës dhe i doli përpara. Vijoi rrugën duke i thënë:

— Po ti mos u nxeh, mor shok. Ja, sa ta nxjerrrim makinën, të bëj nja dy rrugë dhe do të shkoj vetë të shtrohem.

S'kish ç't'i bënte. Shoferi tha:

— Po ajo vullnetarja që iku nga spitali pa mbaruar kurat?

Vijuan rrugën. Ndezën nga një cigare. Njëri mbajti me një dorë shkrepsen, tjetri fijen. Aleksi nga pas i vërejti duart. Gjeti atë karakteristikën e përbashkët për të gjithë shoferët. Duart i kish të mufatura e të skuqura. Gishtrinjtë e enjtur i qenë nxirë.

Të dy janë vullnetarë. Gjer mbrëmë s'njiheshin, por ja që tani u duket sikur janë njojur prej kohësh në kantieret e ndërtimit.

— «Shoferi ndofta si njinte këto gryka», — mendoi Aleksi.

Bashkë me erën që nisi të fryjë përsëri, Aleksi dëgjoi zërin e shoferit.

— Që ditën e parë erdhët në Dibër?

— Erdha ditën e tretë. Sapo pata filluar lejen e zakonëshme dhe vajta në fshat. Lexova gazetën dhe u nisa.

— Çfarë profesioni keni?

— Jam elektriçist

— Eh, ç'fat që paske?

— Si the?

— Paske fat, thashë. E di apo jo, do të bësh elektrifikimin. Do të vesh një gur të madh, të fortë në themelet e socializmit. Me duart e tua do të shkëlqejë tërë Shqipëria nga maja në majë. — Shoferi fliste me ndjenja.

— Për këtë jam shumë i kënaqur. Do të lidh telat e elektrikut edhe atje ku s'ka guxuar të ngjitet kush. Kam vendosur që me t'u kthyer t'i kërkoj ndërmarrjes të më caktojë katër vjet ku të ketë nevojë për elektrifikimin.

Asnjëri s'foli më.

— «Bravo të goftë!» — e uroi shoferi me vehte.

— «Duart i ka të enjtura e të çara dhe s'do t'ia dijë» — mendoi Aleksi për shoferin.

Ata arriten gati me traktorin.

— Pse s'më thatë edhe mua të mirrja ca dërrasa?

— E ku do t'i vinje?

— Linja portat hapura dhe i mbanja mbi gjunjë.

— Na mjaftojnë edhe këto.

Lëshuan dërrasat dhe kontrolluan vendin. Maqina ndodhej gati në mes të ujit.

— Po hedhim disa gurë në Drin — tha traktoristi — pastaj po e zgres traktorin tek ajo ranshtja aty në breg.

Me dorë gurët nuk shkuleshin. Atëhere «Stalineci» iu turr blloqeve të gurëve aty pranë dhe i vërviti në lumë. Gurët u rrokullisën tëposhtë, por... humbisnin në ujet që i mbulonte.

— S'bëhet punë me dërrasat? — e hapi gojën për herë të parë shoferi, pasi arritën këtu.

— Zbresim poshtë shokë!

«Stalineci» pastroi dëborën dhe hapi një farë rruge. Nga malet që zbardhnin nga dëbora nisi një erë me fishkëllima. Ajri u ftoh më tepër. Stalaktitet e gjatë të akullit vareshin nga buza e shkëmbinjve e nga anët e urës. Mbi ujet e turbulltë notonin peta akulli,

Ç'të bënin? Makina nevojitej shumë këto ditë. Pastaj po ta linje tërë dimërit do t'i shkatërrrohej edhe motori.

— Na nxirr kavon!

Dy të tjerët u menduan një çast.

— Jo, jo, tani s'hyhet në ujë. S'është futur gjer më sot njeri në dimër në Drin — tha traktoristi. Ai ishte dibran dhe kurrë s'kish dëgjuar për një gjë të tillë.

— Të ngrin trupi e vdes në ujë — foli shoferi.

— Kavon! — përsëriti prerë Aleksi — Duhet të futem patjetër në ujë.

Traktoristi shkoi të sjellë kavon. Shoferi zbërtheu pallton.

— Jo ti — tha Aleksi dhe nisi të xhvishej vetë.

— Atë makinë ma ka dhënë mua populli. Do të hyj unë — nguli këmbë shoferi, duke hequr pallton.

— Për makinën e popullit përgjigjemi të gjithë. Ti je ftohur. Këtu urdhëroj unë — tha prerazi Aleksi. Dhe u xhvesh vetë, duke mbajtur vëtëm kanatjeren e të mbathurat.

Ai mori kokën e lidhur të kavos që i dha traktoristi dhe u nis. Ujët e ftohtë të lumi e preu si brisk apo futi këmbën. Një e rrënqethur e mprehtë i shkoi në trup. Pastaj e shpejtoi hapin, por duke e zgjedhur me kujdes vendin për të mos hyrë në ndonjë gropë. U fut gjer mbi gjunjë. Mornicat i mbuluan lëkurën e trupit. Thellësia sa vinte po shtohej. E kur ujët i arriti gjer në mes, iu duk sikur një tel me gjëmba po i shtërrngonte belin.

— Kujdes! — një britmë çau ajrin.

Aleksi ktheu kokën andej nga tregonte shoferi me gisht dhe u tërhoq menjëherë mënjanë. Drejt tij aty pranë po vinte një copë akulli rreth një metër. Nisi t'i dridhej. Atëhere lëvizi me fuqi disa herë krahet për t'u nxehur. Gjymtyrët iu mpinë dhe për një cast iu duk vehtja si në ëndërr. Tani kavon, që ishte nderë mbi ujë e merrte rryma me vehte. U bë e pamundur të tërhiqeji. U lodh shumë. Traktoristi e kuptoi këtë gjë. U xhvesh edhe ai nga mezi e poshtë. U fut në ujë gjer afër mezit. E mori kavon në duar dhe e mbështeti mbi gjoks, ndërsa shoferi atje në tokë e mbante mbi kokë. Kështu i dhanë mjaft ndihmë shokut.

Lartësia e ujit i vinte Aleksit gjer mbi gjoks. S'hidhej më çapi. U hodh me not. Notoi nëpër ujin e turbulltë përmes riskave të akullit. Vetëm koka i dukej sipër. Edhe kavoja që zgjatej pas si gjarpër. Ja, arriti edhe tek makina. U kap pas saj dhe u ngrit përgjysmë. Futi kavon në ganxhat e përparme. E lidhi.

E ndjen vehten të pafuqishëm. U mat të fliste, por s'mundi. «Si m'u muar kaq shpejt zëri» — u habit me veten. Kur u lëshua në ujë bëri shenjë me dorë ta tërhiqnin. Shokët e kuptuan përsëri shenjën. Traktoristi u fut më thellë në ujë dhe së bashku me shoferin nisën të tërheqin kavon me të shpejtë.

Aleksi doli gati i ngrirë. I merreshin këmbët.

Traktoristi dhe shoferi u sulën ta fshijnë dhe ta veshin. Ky fërkim dhe rrrobat bënë që ai, ta merrte disi vehten. Traktoristi hoqi peliqen dhe kokoren e tij dhe ia dha. Doli koka e qethur tullë. Pas dy javësh shkonte ushtar. Por nuk kish ndnjur t'i kalonte këto ditë në shtëpi.

Traktoristi e siguroi Aleksin në një vend që nuk e merrte era dhe shkoi tek traktori. «Stalineci» nisi ta tërheqë makinën duke u ngjitur sipër. Kavaja u tendos dhe makina nisi të notojë mbi ujë. Me kujdes për të mos u rrëzuar brinjazi, ai e ngriti në xhade.

I ftohti qe shtuar.

Shoferi, që s'e mbante vendi, i nxiti të nisen dhe i shtyu drejt traktorit.

— Ju shkon, ikni shpejt se Aleksi po ftohet! U duk një makinë.

Shoferi frenoi dhe zbriti poshtë.

— E paski nxjerrë makinën? U lumtë! Se për

besë, kur e mora vesh sot në mëngjez, më theri
në zemër.

Asnjeri s'foli për këtë gjë.

Traktoristi e pyeti:

— Ju po shkoni në Shupenzë, ë? I merrni kë-
ta dy shokët. Po rrruga si është, mos ka dëborë
apo akull që ju pengon?

— Afër burimit duhet pastruar një copë vend.

Traktoristi vetëm me triko shkoi të lirojë ka-
von. Shoferi u tha dy të tjerëve të futen brenda
dhe vetë si futi kokën në kabinë e rrëmoi poshtë
sediljes, doli.

— Merre — i tha traktoristit — se unë kam
dy — dhe i dha një pelice.

— Faleminderit! po emrin si e ke?

— Vullnetar, qeshi tjetri.

— Ngjituni ju të dy! — përsëriti shoferi dhe
i shkeli gazin makinës.

Traktoristi i përshëndeti dhe u nis.

— Shko ti, se unë kam punë — i tha shoferi
Aleksit.

Makina mori drejtimin e kundërt.

Shoferi si shtroi pallton mbi dëborë, u shtri
edhe vetë e filloj të kontrollojë motorrin.

Majat shkëmbore të maleve po i mbulonte një
vello e bardhë dëbore dhe era po shtrihej dalëngag-
dalë në luginat e thella dhe në fushat ku flinte
gruri.

NGJARJE NË LLADOMERICE

Atë mbrëmje bënte ftohët në Lladomericën kufitare. Bora që kish rënë atë mëngjerez ishte ngieshur mirë pas tokës së bërë kallkan. Ftohët ndjeshin edhe shoferët që kishin zbritur nga maqinat e tyre atje në të dalë të fshatit.

— Sa orë keni që po qëndroni këtu? — pyeti njëri.

— Përse pyet? — u përgjigji tjetri shkurtas.

Në fytvrat e këtyre njerëzve të udhëve të largëta shiheshin shënjet e pakënaqësisë dhe të shqetësimit njëkohësisht.

— Si nuk munde ta kalosh këtë të shkretë të përpjete?

— Rrëshqisnin gomat. — u përgjigji shoferi i «Skodës» me targë Tr. 29-39.

C'kish ndodhur? Maqina e ngarkuar me pupullit duke ju ngjitur të përpjete, në të dalë të Lladomericës, kish rrëshqitur e ish ndalur buzë rrugës në kufirin fatal, me një rrotë jashtë rrugës. Teposhtë binte thikë humnera. Kështu, me këtë aksident, qarkullimi drejt Ostrenit të madh dhe Kleinjës ishte ndërprerë. Asnjë maqinë nuk mund ta çonte mallin në vëndin e caktuar për të likuiduar

pasojat e tērmetit, asnjë maqinë nuk mund tē rikthehesh përséri pér t'u ngarkuar me mall. Automjeti pra duhej hequr nga ai vend, por nē ç'mënyrë? Traktorët ishin disa orë larg.

— Futuni ndër maqina, — u foli dikush shoferëve. — Do tē ngrini nga këmbët.

Njeri nuk lëvizi. Duhesh hequr ajo maqinë që zuri rrugën. Po nië manovrim i gabuar do kishte pasoia tē rënda. Mjaftonte një shtytje shumë e lehtë dhe maqina e re tē rrrokullisej nē humnerë.

— Të hapet rruga që tē kalojnë tē paktën «Zis»-at dhe «Gaz»-et — propozoi njëri.

Fshatarët dibranë që kishin arritur me tē shpejtë me lopata e kazma, së bashku me shoferët i u vunë punës pér zgjerimin e rrugës. Binte dheu me copra tē mëdha nga ajo kodër nē anën tjetër tē rrugës. Të tjerë hiqnin gurë që rrëzoheshin. Pas një ore vune tē ngjeshur, kaloi «Zis»-i i parë. Vetëm një pëllëmbë e ndante atë nga takimi me «Skodën» oë ndodhej nē rrezik. Njerëzit muarrën frymë lirisht. Pas saj kaluan edhe dy automjete me tonazh më tē vogël.

— Tani ne kemi mundësi edhe tē heqim «Skodën» — foli aty pér aty një shofer.

Të gjithë kthyen kokën nga ai burrë që shprehу këtë mendim tē guximshëm. Si mund tē hiqei «Skoda» nē këtë vend tē ngushtë dhe pa traktor? Shoferi i porsaardhur, sikur i kuptoi shikimet e tyre, skjaroi:

— Dy «Zis»-a tē ngarkuar do tē vendosen përrapa, kavon do ta kalojnë nëpër trupin e kësaj are tē madhe nē kodër, ndërsa maqinat do tē têrheqin kavon, tē lidhur njeri pas tjetrit.

— Ky është mendim i mirë ndërhyri oficeri i trafikut.

— Nata me errësirën e saj nuk na lejon të manovrojmë, ka rrezik që ndonjëri nga ne ta pësojë me kokë. A nuk është më mirë të presim ditën e nesërme? tha dikush.

Të prisnje deri nesër! Po njerëzit, fëmijët, pleqtë, që kishin mbetur pa strehë nga tërmeti? Ata duheshin futur një orë e më parë në shtëpitë e tyre.

— Shokë, koha nuk pret, vendin do ta ndriçojmë me prozhektorët e «Gaz»-eve.

— Kush ka kavo të gjatë? — ndërhyri oficer Iljazi.

— Kam unë — u përgjigj një shofer trupmadh. — Është nja 20 minuta që këtej maqina e ime.

Bashkë me të shkuau edhe dy të tjerë. Ata u zhdukën dhe u shkrinë në errësirën e madhe atje buzë kufirit. U kthyen duke vrapuar; mezi merrnin frymë.

— Kush do të hypë në «Skodë» ta drejtøjë maqinën?

— Unë — u përgjigj pa ndrojtje Sinani.

Ajo nuk ishte maqina e tij, po ai doli vullnetar, sepse kolegu i tij kish vrarë rëndë dorën e majtë. Ai hypi në kabinën e «Skodës» që ish gati të rrrokullisej në humnerë. Të tjerët e vështruan me admirim dhe shqetësim njëkohësisht veprimin e tij. Mund të ndodhë që nga pesha e tij maqina të rrëzohej poshtë. Ai e la hapur derën e kabinës që për çdo rast të mund të hidhej prej saj. Por a do të mund të kishte kohë? Ai rregulloi për një çast

shaminë me të cilën kish lidhur plagët në ballë
dhe ktheu kokën prapa:

— Gati?

Oficeri i trafikut i ra me të fortë bilbilit, që
ishte shenja e fillimit.

Fshatarët dhe shoferët e tjerë u larguan disa
metra larg vendit të ngjarjes. Kavot mund të kë-
puteshin e dy «Zis»-at të rrëshqisnin përpara, ndër-
sa «Skoda» do të bënte kërcimin e saj drejt hum-
nerës.

— Jepi, jepi edhe pak!

Por maqina nuk luante nga vendi asnjë cen-
timetër. Rrota e «Skodës» e dalë jashtë rruge pe-
ngohej nga disa gurë të mëdhenj.

— Duhen hequr gurët — tha Iljazi. — Kush
do të vijë me mua?

— Unë — tha Feriti, brigadjer i parkut të
mallrave të Tiranës.

Të hiqje gurët e rrotës, do të thoshte të rrezi-
koje vehten, sepse nga heqja e tyre maqina mund
të rrokullisej te poshtë.

Prozhektorët ndriçuan dy fytvra të djersitura
e të shqetësuara. Minutat dukeshin orë. Ja një
gur u rrëzua poshtë duke zhurmuar. Edhe tjetri u
luajt pas pak nga vendi e më në fund u rrokullis.
Asgjë nuk ndodhi. Atmosfera e ngrirë sikur u ngroh
pak; njerëzit muarrën frymë pak më lirisht.

Sinani që gjatë kësaj kohe nuk e kish brak-
tisur kabinën foli përsëri i qetë:

— Gati?

Përsëri fishkullima e bilbilit të Iljazit çau aj-
rin e ftohtë. Maqinat nisën të uturijnë përsëri.
Tymi i motorave mbushi ambientin duke krijar një
vello të hollë transparente. Diçka kërciti.

— Edhe pak, edhe pak — u dëgjuan zëra.

«Skoda» luajti, nga vendi e pas pak rrota që qëndron te jashtë rruge preku më në fund tokën e ngrirë.

— Urra, urra-aaa! —ushtoi. Këto brohoritje entusiaste oshëtinë dhe u përhapën gjer në anën tjetër të kufirit.

— Zbrit tani nga «Skoda» — i thanë Sinanit. Mbarove detyrën.

— Jo, do ta nxjerr deri në xhade poshtë — foli ai me një zë emociononjës.

Pesë kilometra të tjera të vështira nëpër errësirë duke ecur së prapthi nëpër kthesa të rrezikëshme, bëri Sinani deri sa ia nxori shokut të tij maqinën në rrugë të rregulltë.

Në xhade duart e shoferave u shternguan miqësish. Qarkullimi u rivendos. Dritat e maqinave përsëri çanë errësirën: Klenja dhe Ostreni e morën në kohë llëndën e ndërimit.

GJASHTË GUXIMTARET E FSHATIT

Atë natë dëbora binte me tufa të dendura dhe suferina shfrynte shtigjeve. Për kooperativistët e Tërbaçit, në rrethin e Elbasanit kujtimi i asaj nate të ngirë të janarit dhe i asaj që ndodhi atë natë, do të mbetet i gjallë. Atë e tregojnë pleq e të rinj, atje në tokën e përbashkët tek punojnë, apo pranë zjarrit të vatrës. Dikush nga një fshat i largët i Krrabës pyet mikun e tij nga Tërbaçi për historinë e asaj nate. Dhe të dy miqtë, tek dredhin cigaret e trasha, bisedojnë. Kështu gojë pas goje u hap emri i gjashtë vajzave guzimtare të Tërbaçit, që luftuan dhe fituan mbi dimrin e egër.

Ja si ndodhi:...

Dëbora kishte ditë që s'pushonte; por atë mbasdite të shkurtër janari shtërngoi më tepër. Copat e mëdha të dëborës rrëmbeheshin nga era e fuqishme dhe përplaseshin të ngrira diku. Njerëzit kryen punët e pakta të një dite të tillë dhe u mblodhën në vatër, ku bubullonte zjarri.

U hap një derë dhe dëbora e tufani hynë brenda. Nazja një e re, në gjoksin e së cilës shndrisnin katër shenja sulmuesi, mbylli derën dhe me nxitim kaloi oborrin dhe rrugët tërë tërthore të fshatit e trokiti në shtëpinë e Havasë.

— Do të shkojmë në shkollë Hava?

— Po, do të shkojmë, motër...

— Ku do të shkonit moj cuca? — briti plaku nga qoshja. — Nuk e shikoni që jashtë po përmbyset dynjaja?

— Dëbora nuk na pengon, baba, tha Havaja.

— As dëbora, as tufani, as të ftohtit — shtoi Nazja. Plaku qeshi nën mustaqe dhe thellë në shpirt i erdhi mirë që vajzat folën ashtu. Plaka nxitoi në dhomën tjetër dhe i mbështolli së bijës fytyrën e kokën me një copë të trashë e doli me 'to deri tek porta. Qëndroi aty që t'i përcjellë, por ato i mbuloi bardhësia e borës dhe nënës i humbën nga sytë disa hapa më tej.

— T'u çojmë haber Xhemiles, Nadires dhe Lashes së vogël — tha Havaja.

— Ato po na presin në vatrën e kulturës:

— U lumtë, u lumtë atyre cucave! Po burrafat ku janë?

— Ata s'dukan gjékundi — u përgjegj Nazja.

Dhe atje në vatrën e kulturës u takuan gjashtë shoqet. Secila kish me vete librat, fletoret, pendën dhe bojën.

— Duhet me u nisë se ndryshe do të sosim me vonesë në shkollë.

Kështu u nisen për shkollë gjashtë vajzat nga Tërbaçi. Në ditë të ngrohtë kur rruga e përpjetë është e thatë dhe baltë nuk ka, njeriut do t'i duhet afërsisht një orë për të kaluar nga fshati në shkollën 8-vjeçare të Gracenit. Po atë mbasdite janari, sa kohë do t'u duhej vajzave tona për të arritur atje?... Ja, kaluan bokat, kaluan të përpjetën e vështirë të Lamamjeshtit, kaluan sharrën e Sulës...

— Kujdes vajza — thärriti nga kreu i vargut Xhemilja, ajo vajzë e gjallë dhe energjike. — Je-mi tek Gjurma e Mushkës...

Vajzat u kapën dorë për dore dhe filluan të ngjitnin me kujdes të përpjetën. Nëqoftëse këmba do të rrëshqiste, me siguri kishte me humbë thellë në një përrua, që me rrëmbim zbriste faqes së malit.

— Tashti po kalojmë, si po kalojmë këtyre shtigjeve — tha njera nga vajzat, por kur të kthehemë natën vonë nga shkolla, do ta kemi më vësh-tirë... U mat t'u thoshte shoqeve që të ktheheshin, por sytë e tyre iu dukën të fuqishëm dhe vështri-met e tyre sikur i hynë thellë në shpirt, duke i zhdukur frikën. Vajzat shikuan njera tjetrën, sytë u lëshuan xixa. Ato një muaj kishin që ishin kthyer nga hekurudha që të gjashta. Atje në trase qenë dhe ato, kur dha jetën në frontin e luftës së madhë-rishme të ndërtimit Shkurte Vata. Po, a nuk ishte shkolla, mësimi, një front i tillë i vështirë, heroik, që kërkonte mund, sakrifica, guxim?... A nuk ishte një front i lavdishëm, të cilin po e pushtonin? Si mund të dezertosh nga një front i tillë?... Si u betuan ato në vendin ku ra heroina dukagjinase?... A mund të shkelej në këtë betim?... Dhe gjurmata e vajzave vazhduan në drejtësia të shkollës. Ato pen-goheshin, binin mbi dëborë, por përsëri ngriheshin të fuqishme. Duart u qenë ngriië, por në sqetull fort i shtërngonin librat.

Filloi të erret.

— Të ndezim fenerin, vajza, — tha njera.

— Po, duhet ta ndezim. Dhe të gjashta rre-thuan llambën dhe me vështirësi mundën ta ndiz-nin. Por, pas disa hapash, era e shoi.

... Rruja nuk dallohej dhe dëbora, që kish ka-

luar kupën e gjurit, i kish humbur gjurmat rrugës. Errësira e natës së dimrit po vinte me nxitim dhe mjergulla e maleve, ndjehej në frysëmarrje. Por vajzat luftonin, vajzat ecnin. Rrugën që ua fshihte erësira, dëbora, mjergulla e gjenin zemrat e tyre të zjarrta. Po të shikonje atë natë karvanin e vockël të vajzave që binin e ngriheshin, e përsëri vazhdonin. të ecnin fort duke shtërnguar librin, do të pushton te një emocion i thellë. Vajzat nuk shihnin, errësira kish bërë punën e saj, por ato ndjenin thellë në zemër atë dritë të madhe, të bardhë e të fuqishme që ndriçonte larg, përpara tyre. Dhe drejt saj ato shkonin...

— Ja dritaret e shkollës — tha Nadireja.

— Arritëm, shoqe... Dhe arritëm në kohë!

Ato u përqafuan dhe i shtërnguan duart njëra tjetrës. Shkolla me drita të ndezura i ftonte në gjirin e saj të ngrohtë... Atë natë mësimi u bë.

PËR TË SHPËTUAR PASURINË E POPULLIT RREZIKOI DHE JETËN.

... Filloi të binte ngadalë një shi, i hollë, i besdisëshëm, sikur ta hidhte njeri me sitë. Aty nga pasdita, ja dha me të madhe si me gjym. Në mëngjes bariu i ri i NBSH-së së Vrinës, Ademi, tufën e tij, e hodhi matanë lumi Pavël, kapërceu një urë të vogël dhe doli në kullotë. Bar kishte me bollëk. Qe i gjëzuar se me gjithë kohën e keqe ai kishte dhënë fjalën se do ta nxirrte mirë këtë dimër, pa asnje ngordhje, pa asnje dështim, ose të paktën, nuk do linte dele pa qingj. Ja, ky bar do ta ndihmonte të delte me faqe të bardhë. Mirpo ky shiu nuk e linte rehat, e shqetësonte... Mund të dalin prrenjtë, të bëhet ndonjë përmbytje. Shiu u shtua dhe nga çasti në çast po binte më me furi. Ishte ora tre pas dite. Ademi i nisi dhëntë në drejtim të urës së vogël, për t'i larguar nga ky rrezik, për t'i hedhur matanë lumi, për t'i çuar në stallë. Lumi Pavël, zakonisht pa shumë ujë, sot buçiste dhe shkumëzonte nga dallgët e trubullta. Në disa vënde uji kishë vërvshuar. Ademi pati një parandjenjë të keqe: «po sikur të jetë prishur ura, apo dallgët dhe ujërat e Pavles ta kenë mbuluar?» E hipi kopenë mbi ar-

gjinaturën e lumiit dhe u mat t'i drejtonte dhëntë nga ura, po ajo nuk dukej më, e kishin mbuluar ujrat e lumiit. Kopeja ngeli mbi argjinaturë në mes të shiut, në mes të erës, në rrezik që të mbytej në lumë. Dhe si për inat të bariut, disa dele filluan të lindnin në ato kushte shumë të vështira.

Barinj të moçëm të këtyre anëve thonë, se duhet trimëri e madhe të mbash në një rryp toke të lartë, siç është argjinatura një kope të tërë, jo për gjë, po delet kanë një karakteristikë: po të ikij një, nisen pas saj të gjitha, e tërë kopeja, e tërë tufa prej disa qindrash. Po të merrte vetëm një dele drejtimin e lumiit, pas saj do vinin që të gjitha të tjerat. Vështirë e ka patur Adem Meta.

Ai kishte vetëm pak kohë, që qe caktuar në tufën e deleve pëlla. Bëri thirrje partia, dhe ai u përgjegj i pari. Ishte i ri në detyrë, po i njihte zakonet e bagëtisë. Mbi të gjitha e donte tufën si sytë e ballit.

U err, u bë sterrë. Retë ishin ulur deri afër argjinaturës. Shiu nuk pushonte, dhe sikur t'ia bënte për inat Ademit, vazhdonte të binte çdo minutë më me rrëmbim. Lumi buçiste e gjëmonte me tershëllim. Delet vazhdonin të pillnin njëra pas tjetrës. Ademi bariste me kujdes nga kreu në fund të tufës. Shikonte delet se mos afroheshin nga buzë dhe binin në lumë, u afrohej deleve që pillnin dhe u merrte qingjat e vegjël, i vinte në gjirin e tij për t'i ngrohur, i mbanite nën mushamanë e tij dhe mëndte në errësirë. Ishte në mëshirën e tekave të natyrës, e cila me gjëmimet, ujërat dhe erën e fortë sikur desh ta thyente, po s'e theu dot, se vullneti i këtij bariu ishte i fortë, atë e kishin kalitur mësimet e partisë e të shokut Enver.

Luftonte në këtë natë të keqë për të shpëtuar delet e popullit dhe mendonte: Ka dhe më keq. Shokët e mi e kanë pas dhe më keq, kanë luftuar me zjarrin si Muhamet Shehu, kanë luftuar me detin si Adem Reka, kanë luftuar dhe luftojnë me errësirën si Fuat Çela, kanë luftuar me dëborën e tufaňin si vullnetarët në Dibër dhe Librazhd, kanë luftuar nën tokë, kanë luftuar në ajër dhe kanë fituar. Po un? Nuk do të jepem, — mendonte bariu: Shkurta qe 15 vjeçë dhe nuk iu tremb rrezikut, Zonja Çurre luftoi me gjermanët dhe nuk u tremb, komunistët janë hedhur mbi tankset e armikut dhe nuk janë trembur. Edhe unë nuk do jepem. Dhe nuk u dha. Tërë natën shfryu si i zemëruar veriu, buçiti lumi, rënroi era me tërsëllim, gjëmonin malet për rrëth dhe shiu vazhdonte të binte, po ai nuk u dha, tërë natën, për 14 orë me radhë, qëndroi në këmbë nga një cep i kopesë tek cepi tjetër, nga një dele tek tjetra, shikonte anët e argjinaturës dhe gjithmonë i vinte rrötull kopesë. U lag i téri deri në mish, u tha nga të ftohtit, po nuk u përkul. Kur ra mëngjezi, shokët, që e kërkonin e gjetën më në fund. Ishte pështetur diku, fuqitë e kishin lënë, ishte mbuluar me mushama. Shokët thanë se mos kishte pësuar gjësendi. Zbuluan mushamanë, po vunë re se ai nën mushama kishte 12 qingja të vegjël, që kishin lindur atë natë. I mbante aty ngjitur me trupin e tij, që të mos i ftoheshin, që të mos i ngordhnin, që t'i ngrohte me trupin e tij, me frymën e tij...

Shokët tregojnë: Tufa e deleve ishte grumbulluar rrëth tij sikur donte mbrojtje, sikur donte ta mbronte bariun.

Të lumtë! — e përgëzonin shokët, po ai buzë-

qeshte lehtë me buzët e nxira nga të ftohit, me buzët e enjtura e të bumbryera nga era dhe murrlani. Në fillim nuk i kuptonte ç'ishin këto lëvdata dhe tha — «pa shikoni, numuroni delet. Mos mugon ndonjë?» I u përgjigjën: «jo asnjë nuk mungon, të lumtë». I bënë një zjarr të madh dhe e ngrohën shokun e tyre, i thanë teshat e lagura dhe i drejtuat për tek stallat. Pranë tij ishin delet, blegërinin qingjat. Ai i shikonte dhe shpirti i gufonte nga gjëzimi. Asnjë nuk pësoi gjësendi. Vërtetë u rrezikova, po e kam ndër-gjegjen të qetë, e kam zemrën të qetë. Unë e bëra detyrën time. E pse të veja të ngrohesha diku? Qëndrova tërë natën me delet se ato janë gjaku im, gjaku i tërë popullit tim.

Në përgjigje të këtij akti patriotik, të frysës revolucionare që ka shpërthyer anë e kënd vendit tonë, punëtorët e Vrinës, blegtorët sidomos, morën një varg zotimesh të guximëshme.

Blegtorët e Vrinës thonë:

— Për partinë tonë, për Atdheun tonë ne nuk do kursejmë asgjë, as jetën tonë. Ne punojmë e jetojmë këtu buzë kufirit, prandaj ne jemi edhe kufitarë, edhe blegtorë. Shoku ynë Adem Meta tregoi një trimëri të madhe, ne zotohem se do të ndjekim shembullin e tij dhe të të gjithë trimave të luftës, trimave të punës, që ia kanë zbardhur faqen partisë dhe tërë Shqipërië...

per se et non auctoritate. Sed omnes litterae sicut
etiam scripturae sunt deus auctoritas. Non enim
scripturae solum, sed etiam litterae omnes sunt deus
auctoritas. Et hoc est manifestum. Quia et litterae
scripturae sunt auctoritas, et litterae sicut etiam
scripturae sunt auctoritas. Hoc est manifestum.
Et hoc est manifestum. Quia et litterae scripturae
sunt auctoritas, et litterae sicut etiam scripturae
sunt auctoritas. Hoc est manifestum. Quia et litterae
scripturae sunt auctoritas, et litterae sicut etiam
scripturae sunt auctoritas. Hoc est manifestum.
Et hoc est manifestum. Quia et litterae scripturae
sunt auctoritas, et litterae sicut etiam scripturae
sunt auctoritas. Hoc est manifestum. Quia et litterae
scripturae sunt auctoritas, et litterae sicut etiam
scripturae sunt auctoritas. Hoc est manifestum.
Et hoc est manifestum. Quia et litterae scripturae
sunt auctoritas, et litterae sicut etiam scripturae
sunt auctoritas. Hoc est manifestum. Quia et litterae
scripturae sunt auctoritas, et litterae sicut etiam
scripturae sunt auctoritas. Hoc est manifestum.

PËRMBAJTJA

Faqe

1) «Gjoli i Turbullit u tha». <i>Vath Koreshi</i>	5
2) «Edhe shok i mirë e i shkolluar, edhe bujk i mirë kryetari ynë» <i>Ismet Cibaj</i>	14
3) «Brigada vendosi të shkojë në fshat» <i>Brigada «Shkurte Pal Vata»</i>	20
4) «Bardha» <i>Flora Mullaymeri</i>	23
5) «Fitojnë mbi furtunën» <i>Hamit Boriçi</i>	33
6) «Ushtarë besnikë të Partisë» <i>Enver Cekaj</i>	41
7) «Ai u kthyte të punojë përgjithëmonë në fshat Ramo Zani, <i>Bektash Zite</i>	46
8) «Elektricistët çajnë tufanet e dëborës» <i>Pjetër Dedaj</i>	51
9) «Një natë në tunel» <i>Ahmet Golemi</i>	54
10) «Vështirësitë mposhten» <i>Ismail Hoshafi</i>	61
11) «Ç'i sheh syri, ia bën dora» <i>Foto Gjidede</i>	65
12) «Gjallëri e re në bjeshkët e veriut» <i>Osman Allkja</i> ..	68
13) Dashuria për shokun» <i>Gjergj Ndojaj</i>	75
14) «Udhë vullnetarësh...» <i>Xhevahir Spahiu</i>	83

Faqe

15) «Zevendësimi» <i>Loni Papa</i>	90
16) «Naftëtari dhe nafta» <i>Osman Alikja</i>	96
17) «Vullnetarët» <i>Arian Kadlu</i>	102
18) «Ngjarje në Lladomericë» <i>Fatmir Dibra</i>	111
19) «Gjashtë guxiutarët e fshatit» <i>Osman Kazazi</i>	116
20) «Për të shpëtuar pasurinë e popullit rrezikoi dhe jetën» <i>Thanas Çakalli</i>	120

Espe

- 6 identiteti i myftit, qëndrueshmëri i përgjegjësisë së
7 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i konsideruar si
8 një vlerë e madhe e vlerësuar, i cili ka qenë e
9 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
10 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
11 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
12 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
13 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
14 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
15 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
16 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
17 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
18 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
19 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
20 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
21 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
22 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
23 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
24 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
25 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
26 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i
27 përgjegjësuar me shumë mënyrë, qëndrueshmëri i
28 fshatit, i përgjegjësuar nga komuniteti i fshatit, i

1963/1964
M. A. M. S.

2204-65

Tirazhi: 4000 kopje Formati 70 x 100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH Shtypshkronja «MIHAL DURI»
Stabilimenti i Botimeve Arësimore — Tiranë, 1968